# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7154
E premte, 29 mars 2024
Çmimi 0. 50


## MAPL-ja ndan mbi 8 milionë euro për 11 komuna
FAQE 6




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


DËSHTON THEMELIMI I KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR PËR KONTRATAT NJËBURIMORE

# OPOZITA, KRITIKA TË SHUMTA NË KUVEND RRETH KONTRATAVE NJËBURIMORE TË QEVERISË KURTI
FAQE 4-5



Kuvendi i Kosovës, në mungesë të kuorumit në vendimmarrje, ka dështuar ta themelojë të enjten Komisionin Hetimor Parlamentar për kontratat njëburimore të qeverisë Kurti. Për themelim të komisionit votuan vetëm deputetët e opozitës, ndërsa mazhoranca nuk mori pjesë në votim, madje nuk i paraqiti as emrat e deputetëve që do të jenë pjesë e komisionit

## AKTUALE



### POLONIA HAP PËRKOHËSISHT KUFIRIN ME UKRAINËN
F. 2

### HARADINAJ: PDK-ja PO IA PLOTËSON KËRKESËN KURTIT OSE KANË KOALICION SE SI TË ECIN DREJT ZGJEDHJEVE
F. 3

Reagim i KMDLNj-së

### TË SËMURËT ME KANCER, NË MËSHIRËN E ASKUJT!
F. 10

## EKONOMI



### GJATË SHKURTIT MËRGATA DËRGOI NË KOSOVË RRETH 88 MILIONË EURO
F. 8

### ZKA-ja AUDITON SHITJET DIREKTE TË AKP-së
F. 8

## SPORT



### OLTI HYSENI: JAM DANEZ, NUK LUAJ PËR KOSOVËN
F. 10

### PDK-ja BËHET ME KRYESI TË RE, BEDRI HAMZA EMËROHET NËNKRYETAR
F. 5

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të enjten ka votuar kryesinë e re në të cilën ka emëruar kryetarin e Mitrovicës, Bedri Hamzën, nënkryetar të kësaj partie. Në kryesinë e re, Vlora Çitaku është emëruar sekretare e përgjithshme, Uran Ismaili ka mbetur nënkryetar, Agim Aliu, Shaqir Totaj, Besianë Musmurati, Mimoza Ahmetaj, po ashtu, kanë marrë pozitën e nënkryetarëve



### KOSOVA BËN HAP DREJT ANËTARËSIMIT NË KËSHILLIN E EVROPËS
F. 4





RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Polonia hap përkohësisht kufirin me Ukrainën

**Varshavë, 28 mars -** Polonia ka hapur përkohësisht një pikë kufitare me Ukrainën, tha Kievi më 28 mars, përderisa përfaqësuesit qeveritarë u takuan në Varshavë për t'i ulur tensionet të shkaktuara për shkak të importeve të drithërave ukrainase.
Shërbimi shtetëror i rojeve kufitare të Ukrainës tha përmes një deklarate se 120 kamionë pritet të kalojnë pikëkalimin Uhrjniv - Dolobiçuv për në Poloni. Ky shërbim tha se pikëkalimi do të mbetet i hapur deri më 2 prill.
Njoftimi u bë përderisa qeveria e Polonisë dhe e Ukrainës zhvilluan një takim mbi gjashtorësh në Varshavë për të diskutuar për çështjen e importeve të drithërave ukrainase, por duket se bisedimet nuk prodhuan një rezultat.
Pikëkalimet kufitare me Ukrainën janë bllokuar për javë të tëra, pasi fermerët në Poloni po kërkojnë rivendosjen e tarifave doganore ndaj importeve të bujqësisë nga Ukraina, që u hoqën pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës më 2022.
Fermerët argumentojnë se Ukraina po dërgon në Evropë drithëra të lira, duke ua pamundësuar atyre t'i shesin produktet vendore. "Është e vështirë të pritet ndonjë rezultat pas këtyre bisedimeve, ndonjë marrëveshje specifike, për shembull, për çështjen e produkteve bujqësore", tha Jan Grabiec, shefi i zyrës së kryeministrit. "Ne po vazhdojmë dialogun me të dyja palët".
Ministri i Bujqësisë i Ukrainës, Mykola Solsky, shkroi në X, se bisedimet me Poloninë ishin "të vështira, por të sinqerta". Sipas tij, zgjidhjet për çështjen e importeve bujqësore ukrainase është diskutuar dhe do të bëhen publike së shpejti.



# Ukraina shkatërron dhjetëra dronë ruse



**Kiev, 28 mars -** Forcat ukrainase kanë rrëzuar 26 nga 28 dronët e lëshuar gjatë natës nga Rusia, tha ushtria e Kievit të enjten, më 28 mars.
Dronët Shahed, të prodhimit iranian, u shkatërruan në zonat në lindje, jug dhe juglindje të Ukrainës, shtuan Forcat Ajrore ukrainase.
Guvernatori i rajonit të Zaporizhjës tha përmes një postimi në Telegram se dy gra u plagosën pasi copëzat e një droni të shkatërruar ranë në një zonë të banuar në kryeqytetin rajonal.
Prokurorët në rajonin lindor të Harkivit raportuan se një restorant, një dyqan dhe disa zyra pësuan dëme nga fragmentet e tre dronëve.
Forcat Ajrore ukrainase thanë, po ashtu, se Rusia gjatë natës ka kryer sulme me disa lloje raketash, duke mos dhënë më shumë detaje.
Rusia vazhdimisht kryen sulme ajrore ndaj qendrave të populluara, që gjenden larg vijave të frontit, teksa Moska po vazhdon pushtimin e paprovokuar të Ukrainës që nisi në shkurt të vitit 2022.

# Putini thotë se Rusia s'do ta sulmojë NATO-n, por do t'i rrëzojë F16-shat në Ukrainë

**Moskë, 28 mars -** Rusia nuk ka plane për asnjë vend të NATO-s dhe nuk do ta sulmojë Poloninë, shtetet e Baltikut apo Republikën Çeke, por nëse Perëndimi furnizon me avionë luftarakë F-16 Ukrainën, fluturaket do të rrëzohen nga forcat ruse, deklaroi lideri rus Vladimir Putin.
Pushtimi rus i Ukrainës, që nisi më 2022, ka nxitur krizën më të thellë në raportet në mes të Rusisë dhe Perëndimit që nga Kriza kubane e raketave më 1962.
Duke folur me pilotët rusë, Putini tha se aleanca ushtarake e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara është zgjeruar në lindje drejt Rusisë që nga rënia e Bashkimit Sovjetik më 1991, por Moska, tha ai, nuk ka plane të sulmojë ndonjë shtet të NATO-s.
"Ne nuk kemi qëllime agresive ndaj këtyre shteteve", tha Putini, sipas transkriptimit të publikuar nga Kremlini të enjten. "Ideja është që ne do të sulmojmë një vend tjetër - Poloninë, shtetet e Baltikut dhe çekët që, po ashtu, po frikësohen, është absurditet i plotë. Këto janë gjepura".
Kremlini, që e akuzon ShBA-në se po lufton kundër Rusisë përmes mbështetjes së Ukrainës me para, armë dhe inteligjencës, ka thënë se raportet me Uashingtonin ndoshta kurrë nuk kanë qenë më të këqija.
I pyetur lidhur me avionët luftarakë F-16, të cilat Perëndimi ka premtuar se do t'ia dërgojë Ukrainës, Putini tha se fluturake



të tilla nuk do ta ndryshojnë situatën në Ukrainë. "Ne do të shkatërrojmë këto fluturake siç po shkatërrojmë çdo ditë tanket, autoblindat dhe pajisjet e tjera, përfshirë edhe raketahedhësit", tha Putin.
Udhëheqësi rus tha se avionët F-16, po ashtu, mund të bartin armë bërthamore.
"Sigurisht, nëse këta avionë do të përdoren nga bazat ajrore nga një shtet i tretë, për ne do të bëhen caqe legjitime për ne", tha Putini.
Deklaratat e Putinit vijnë pasi një ditë më herët ministri i Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, tha se avionët F-16 duhet të dërgohen në Ukrainë në javët në vijim.
Ukraina, që për dy vjet po përballet me luftën e nisur nga Rusia, për muaj të tërë ka kërkuar nga aleatët e saj t'i dërgojnë avionë F-16.
Belgjika, Danimarka, Norvegjia dhe Holanda janë në mesin e shteteve që janë zotuar se do t'i japin Kievit fluturake të tilla. Ndërkaq, një grup shtetesh kanë premtuar se do të ndihmojnë në trajnimin e pilotëve ukrainas.

## Bullgaria drejt zgjedhjeve të gjashta brenda tre vjetësh

**Sofje, 28 mars -** Bullgaria po përgatitet edhe për një palë zgjedhje të përgjithshme - të gjashtat që nga prilli i vitit 2021 - pasi partia populiste "Ka një popull të tillë" (ITN) më 28 mars refuzoi ta formojë qeverinë. Kjo është partia e tretë që refuzon mandatin qeveritar.
Paraprakisht, partia e qendrës së djathtë GERB, dhe ish-partneri i koalicioni, partia properëndimore "Vazhdo Ndryshimin/Bullgaria Demokratike" (CCDB) thanë se nuk mund të formojnë një kabinet qeveritar.
Vendimi i ITN-së i hap rrugën presidentit Rumen Radev, që të caktojë një qeveri në detyrë dhe ta caktojë datën e zgjedhjeve që duhet të mbahen brenda dy muajsh.
Bullgaria do të votojë për zgjedhjet e Parlamentit Evropian më 9 qershor dhe dy palë zgjedhjet mund të mbahen brenda një dite. Megjithatë, data e zgjedhjeve varet nga aftësia e Radevit që të caktojë sa më shpejt një qeveri në detyrë.
Pas zgjedhjeve të mbajtura prillin e vitit të kaluar, Bullgaria kishte një qeveri të përbashkët të mbështetur nga reformistët e CCDB-së dhe GERB-i. Ata ishin pajtuar për një ekzekutiv 18-mujor dhe që udhëheqja e tij të bëhej përmes rotacionit, përkatësisht fillimisht kryeministër të ishte Nikolay Denkov nga CCDB-ja dhe pas nëntë muajsh, detyrën ta merrte Maria Gabriel nga GERB-i.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

DËSHTON THEMELIMI I KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR PËR KONTRATAT NJËBURIMORE

# Opozita, kritika të shumta në Kuvend rreth kontratave njëburimore të qeverisë Kurti

**Kuvendi i Kosovës, në mungesë të kuorumit në vendimmarrje, ka dështuar ta themelojë të enjten Komisionin Hetimor Parlamentar për kontratat njëburimore të qeverisë Kurti. Për themelim të komisionit votuan vetëm deputetët e opozitës, ndërsa mazhoranca nuk mori pjesë në votim, madje nuk i paraqiti as emrat e deputetëve që do të jenë pjesë e komisionit**



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 MARS - Në mungesë të kuorumit, ka dështuar të formohet Komisioni Hetimor Parlamentar që do t'i hetojë kontratat njëburimore të qeverisë Kurti, pasi deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk kanë marrë pjesë në votim.

Në sallë ishin të pranishëm 63 deputetë, ndërsa në votim morën pjesë 26, përfshirë edhe Konjufcën që votoi për themelimin e këtij komisioni.

Gjatë diskutimit që ka zgjatur rreth tri orë, deputetët e opozitës e kanë akuzuar pushtetin për numër të madh të kontratave njëburimore të nënshkruara gjatë këtij qeverisje.

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se deri në 200 milionë euro shkon shifra e kontratave njëburimore nga kjo qeveri. "Duhet t'i analizojmë këto kontrata dhe të shohim sa janë reale. Janë kontrata njëburimore me shuma marramendëse. Shohim sigurimin e objekteve të KEK-ut e çështje banale që janë kontratat burimore. Kontratat njëburimore janë kontrata të nënshkruara në një tavolinë duke fshehur transparencën. S'ka transparencë", është shprehur Tahiri.

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka hedhur akuza në drejtim të qeverisë Kurti për numrin e lartë të kontratave njëburimore.

Këto kontrata, sipas tij, kanë një emër - "tender sekret". "Ajo që po provojmë të bëjmë këtu, dua të përgëzoj deputeten Bajrami që ka nisur këtë iniciativë. Është përshkrimi i një praktike të shpërndarë në gjithë sistemin publik të Kosovës. Kjo praktikë ka një emër dhe i thonë tender sekret. Tenderët sekretë janë shpërndarje e parasë së shtetit, prej buxhetit te operatorët, bizneset, pa asnjë procedurë, garë, drejtpërsëdrejti marrëveshjet direkte", ka thënë Abdixhiku.

Sipas tij, edhe derisa po flitej në Kuvend, dikush nga LV-ja ka qenë duke nënshkruar një tender sekret. "Sot teksa flasim, dikush në LV është duke nënshkruar një tender sekret. Kjo praktikë po rritet. Vitin e parë ishin 30 milionë euro, vitin e dytë u bënë 70, në vitin e tretë 109 milionë euro tenderë sekretë", ka deklaruar Abdixhiku.

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, gjatë seancës parlamentare ka theksuar se gjatë dy viteve në gjashtë ministri dhe në KEK janë lidhur 220 kontrata njëburimore në vlerë prej 153 milionë eurosh.

Tahiri konsideron se kontratat njëburimore janë përdorur në kundërshtim me ligjin derisa, sipas tij, e kanë ngufatur konkurrueshmërinë në sektorin privat. "Ka një frikë serioze të kësaj qeverie në raport me hetimin e tenderëve njëburimorë që shuma e tyre vjen në 209 milionë euro. Kjo qeveri ka kontraktuar 781 tenderë njëburimorë të cilët pa asnjë dyshim janë burim i korrupsionit, burim i keqpërdorimit dhe e ngufatin konkurrueshmërinë e sektorit privat në këtë temë. Se kontratat njëburimore janë përdorur në sasi të madhe dhe kundërshtim me ligjin tregon fakti se vetëm në vitin 2022/23, në gjashtë ministri dhe në KEK, janë nënshkruar 220 kontrata në vlerë prej 153 milionë eurosh", është shprehur Tahiri.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adnan Rrustemi, ka thënë se opozita në mungesë të kauzave po mundohet që me komisione hetimore të hedhë baltë mbi çdo gjë dhe çdo kë. Ai ka thënë se në këto kontrata nuk ka asgjë të dyshimtë e që duhet të hetohet. "E them me bindje të plotë se në këto kontrata nuk ka asgjë të dyshimte e që duhet të hetohet. Opozita, në mungesë të kauzave dhe në përballje me humbje të besimit të qytetarët, po mundohet që me komisione të tilla hetimore të hedhë baltë mbi çdo gjë dhe mbi çdo kë. Po mundohet ta kthejë Kuvendin e Republikës në organ të akuzës dhe baltosje, por ne nuk mund ta lejojmë këtë çoroditje. Kuvendi e ushtron pushtetin legjislativ dhe kompetencat e tij janë të qarta", ka deklaruar Rrustemi.

Themelimi i komisionit hetimor për kontratat njëburimore në qeverinë Kurti është iniciuar nga PDK-ja.

# Haradinaj: PDK-ja po ia plotëson kërkesën Kurtit ose kanë koalicion se si të ecin drejt zgjedhjeve



PRISHTINË, 28 MARS - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, në një deklaratë për medie të enjten, ka bërë me dije se kjo parti ende nuk e ka caktuar kandidatin për kryeministër për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Haradinaj thotë se nuk janë si PDK-ja me ia mbajt agjendën Kurtit rreth datës së zgjedhjeve. Sipas tij, njëherë duhet të vendoset se si të shkohet në zgjedhje e jo të flitet për datën e mbajtjes së tyre. "Duhet të shkarkohet qeveria, e mënyra se si shkojmë në zgjedhje ka shumë rëndësi. Unë po dëgjoj se z. Krasniqi po i propozon data Kurtit. Ne së pari duhet ta definojmë mënyrën se si të shkojmë në zgjedhje, pra data pason pas procesit, njëherë duhet të shkarkohet qeveria Kurti. Para se të flasim për datën, duhet të flasim për mënyrën se si shkojmë në zgjedhje. Ne kemi mocion për shkarkim të qeverisë. Kështu është radha e punëve nëse shkojmë drejt me shpërndarje të Kuvendit që kërkon 2/3-at është kryesisht agjenda e Kurtit, që i bie se PDK-ja po ia plotëson kërkesën Kurtit ose ka koalicion me Kurtin për mënyrën se si me ec përpara drejt zgjedhjeve", ka thënë Haradinaj.

E vetmja nga partitë opozitare që ka zyrtarizuar deri më tani kandidatin për kryeministër është Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Kryetari i këtij subjekti, Memli Krasniqi, në një konferencë për medie mbajtur të mërkurën, ka zyrtarizuar kandidaturën e Bedri Hamzës për kryeministër nga kjo parti. Ai tha se Hamza është njeriu i duhur për këtë pozitë dhe për kohën në të cilën po kalon Kosova, andaj edhe i ka kërkuar të marrë këtë përgjegjësi.




# Kosova bën hap drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës

Prishtinë, 28 mars - Komiteti për Politikë dhe Demokraci i Këshillit të Evropës ka miratuar raportin e raportueses për Kosovën, Dora Bakoyannis, në të cilin rekomandohet që shteti ka përmbushur kushtet për t'u bërë anëtare e plotë e Këshillit të Evropës.

Hapi i radhës, sipas këtij komiteti, do të jetë më 18 prill, kur do të hidhet në votim ky raport para Asamblesë Parlamentare në përbërjen e saj të plotë.

Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës do të ishte katalizator që "Kosova të vazhdonte të bënte përparim në forcimin e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit si dhe t'i adresojë sfidat dhe çështjet shqetësuese", tha Komiteti për Politikë dhe Demokraci.

Sa i përket themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, në njoftimin e Komitetit pas takimit të 27 marsit u tha se ai duhet të jetë një "angazhim pas anëtarësimit për Kosovën" që do të ndihmonte të sigurojë mbrojtje për të drejtat e serbëve në Kosovë dhe sa i përket shpronësimit të pronave në veri, Komiteti tha se ato duhet të kryhen "duke respektuar ligjin" dhe në përputhje të plotë me Planin e Ahtisaarit.

Përmes njoftimit, Komiteti tha, po ashtu, se është në dijeni të "përkeqësimit të situatës së sigurisë në komunat në veri të Kosovës", duke theksuar se "rreziku për dhunë në Kosovë është i madh" dhe se siguria varet "nga mbrojtja e të drejtave të komunitetit serb, përshkallëzimi i tensioneve dhe normalizimi i raporteve me Serbinë".

Duke pasur parasysh numrin e vendeve anëtare të Këshillit, që nuk e njohin Kosovën si shtet, Komiteti bëri thirrje për "diplomaci, dialog dhe kompromis", duke i bërë thirrje Komitetit të Ministrave që të sigurohen që anëtarësimi i Kosovës të bëhet pa "paragjykime ndaj qëndrimeve të shteteve individuale sa i përket shtetësisë së Kosovës".

## Kosova mirëpret vendimin, Serbia e quan "skandaloz"

Në Kosovë u mirëprit vendimi i Komitetit për Politikë dhe Demokraci i Këshillit të Evropës. Zëvendësministri për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Kreshnik Ahmeti, tha se opinioni i raportueses Bakoyannis rekomandon anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës "pa asnjë parakusht shtesë".

"Asnjë nga zotimet që duhet t'i marrë përsipër Kosova nuk kërkohet të realizohen para anëtarësimit. Madje në pikën 11 thuhet qartë se zotimi duhet të adresohet pas anëtarësimit", shkroi ai në Facebook. Sipas tij, të gjitha propozimet që të vendosen parakushte të reja "janë refuzuar nga shumica e anëtarëve të Komitetit, gjë që tregon se Kosova duhet të bëhet anëtare në maj të këtij viti dhe parakushtet e reja do të ishin të padrejta".

Në raportin e Bakoyyanis, tha zëvendësministri Ahmeti, kërkohet edhe largimi i fusnotës që vendoset para emrit të Kosovës, "fusnotë e cila është përdorur që nga viti 2008 në çdo raport dhe komunikim mbi dhe me Kosovën. Gjithashtu, rekomandohet që Kosova të ftohet si shtet, sipas nenit 4 të Statutit të Këshillit të Evropës, dhe jo si vend sipas nenit 5".

Ndërkaq, deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, që ishte i pranishëm në takim, tha se raporti u votua me 31 vota për, katër kundër dhe një abstenim. Por, sipas tij, gjatë takimit kishte mospajtime. "Në Komitet deputetët ishin të ndarë. Në njërën anë Serbia kundërshtonte, në anën tjetër kishte pothuajse konsensus në mbështetje të anëtarësimit të Kosovës", shkroi ai në X, që më herët njihej si Twitter.

Mediet në Kosovë kanë raportuar se kundër raportit kanë votuar dy deputetë nga Serbia, një votë kundër ishte nga deputetët e Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovina, ndërkaq një deputet i Greqisë ka abstenuar.

Në Serbi, ministri i Punëve të Jashtme në mandatin teknik, Ivica Daçiq, e quajti vendimin për rekomandimin për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës "të turpshëm dhe skandaloz".

Daçiqi tha se ky vendim "shkatërron të gjitha parimet mbi të cilat mbështetet Këshilli i Evropës, sepse për herë të parë është propozuar pranimi i një territori që nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe nuk është i njohur ndërkombëtarisht", u tha në njoftimin e publikuar në uebfaqen e Ministrisë së Jashtme të Serbisë.

## Cilat janë procedurat e mëtejme?

Pas këtij votimi në Strasburg, çështja procedon në Asamblenë Parlamentare më 18 prill dhe nëse merr miratimin edhe në këtë institucion, atëherë fjalën përfundimtare për anëtarësimin e Kosovës duhet ta japë Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës gjatë një mbledhjeje që do të mbajë në muajin maj.

Kosova ka aplikuar në majin e vitit 2022 për anëtarësim në Këshillin e Evropës.

Anëtarësimi i Prishtinës është riaktualizuar në javët e fundit pasi, me kërkesën e Qeverisë së Kosovës drejtuar Agjencisë Kadastrale për transferimin e 24 hektarëve tokë në emër të Manastirit të Deçanit, është përmbushur një nga kushtet kryesore për anëtarësim.

Në një intervistë dhënë për Radion Evropa e Lirë më 15 mars, emisari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, sugjeroi se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë dhe çështja e disa shpronësimeve në veriun e banuar me shumicë serbe mund të nxirren si kushte shtesë nga disa shtete evropiane për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës.

Megjithatë, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, deklaroi më herët gjatë 27 marsit se themelimi i Asociacionit - për të cilën Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje qysh më

→

## 26 qendra të votimit në veri i plotësojnë kriteret ligjore për vendndodhjen e tyre

Prishtinë, 28 mars - Në mbledhjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është paraqitur një raport i përgjithshëm lidhur me përgatitjet e deritashme për organizimin e procesit të votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.
Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka dhënë hollësi nga ky raport. Ai ka thënë se, sipas raportit, Komisionet Komunale të Zgjedhjeve në këto katër komuna janë funksionale dhe aktualisht janë duke bërë vlerësimin e qendrave të votimit që do të përdoren për procesin e votimit më 21 prill.
"Sipas të dhënave nga ky proces i vlerësimit, është konstatuar se të gjitha qendrat e votimit, 26 sosh, në komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Zubin Potok, i plotësojnë kriteret ligjore për vendndodhjen e tyre, ndërsa një numër i vogël nuk kanë qasje të lehtë për personat me nevoja të veçanta. Procesi i vlerësimit të qendrave të votimit në komunën e Leposaviqit, ku numri i tyre është më i madh, 18 sosh, është duke vazhduar", ka thënë Elezi.



# Kosova dhe Austria nënshkruajnë deklaratë të përbashkët të bashkëpunimit



Prishtinë, 28 mars - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, së bashku me homologen e saj nga Republika Federale e Austrisë, ministren Alma Zadić, kanë nënshkruar Deklaratë të Përbashkët të Bashkëpunimit mes dy shteteve Kosovë-Austri.
Pas nënshkrimit të Deklaratës, dy ministret Haxhiu dhe Zadić kanë mbajtur konferencë për media, ku kanë folur për bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e mira mes dy shteteve në fushën e sundimit të ligjit.
Ministrja Haxhiu në fjalën e saj tha se çdo ditë e më shumë Republika e Kosovës po vazhdon të ndërtojë marrëdhënie të mira bilaterale me vende të tjera, të cilat vazhdojnë ta ndihmojë shtet-ndërtimin e vendit tonë, por edhe forcimin e subjektivitetit juridik ndërkombëtar.
Më tutje, ministrja Haxhiu tha se Deklarata e Përbashkët lidhur me Fuqizimin e Sundimit të Ligjit, por edhe procesi i fillimit të negocimit të Marrëveshjes për Bashkëpunim Gjyqësor në Çështjet Penale, përveç se thellojnë marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve Kosovë - Austri, kontribuojnë edhe në fuqizimin e sundimit të ligjit.
Ministrja Haxhiu tregoi se për gjatë tre viteve qeverisje janë shënuar 29 akte/marrëveshje ndërkombëtare si dhe nisma për marrëveshje të nënshkruara dhe miratuara, mbi 16 701 kërkesa dhe përgjigje në kuadër të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, 144 persona të ekstraduar në periudhën mars 2021 - mars 2024, gjithashtu 21 persona të transferuar për periudhën e njëjtë.
Në fund, ministrja Haxhiu falënderoi Republikën Federale të Austrisë për ndihmë në çlirim dhe shtetndërtim të Republikës së Kosovës dhe për vullnetin e treguar për fuqizim të sundimit të ligjit.
Ndërsa ministrja e Drejtësisë nga Republika Federale e Austrisë, Alma Zadić, tha se vendi i saj i njeh përpjekjet dhe arritjet e Kosovës për sundimin e ligjit dhe se mbeten mbështetësit afatgjatë në fushën e sundimit të ligjit.
Ndër të tjera, ministrja Zadić tha se Republika Federale e Austrisë do ta mbështesë Kosovën për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe në procesin e mëtutjeshëm integrues në Bashkimin Evropian.

2013 - nuk është kusht për anëtarësimin e Këshillit të Evropës. Ajo tha se në raportin e Bakoyannis qartëson në paragrafin e 11 se "kur flitet për Asociacionin, flitet si një prej detyrimeve pas anëtarësimit, pra nuk flitet për këtë fazë për themelim të Asociacionit".
Këshilli i Evropës është organizatë lidere në Evropë në fushën e të drejtave të njeriut. Pjesë e tij janë 46 shtete, përfshirë 27 vende anëtare të Bashkimit Evropian dhe të gjitha vendet e rajonit.
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut - me seli në Strasburg, Francë - bën monitorimin e zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## Kurti: Vlerat themeltare të Këshillit të Evropës i rrinë natyrshëm qeverisjes sonë të mirë e progresiste

Për këtë avancim të Kosovës për në KE, ka reaguar kryeministri Albin Kurti. Ai ka thënë se dy vjet e gjysmë është bërë punë e pareshtur sistematike, institucionale dhe politike. "Dhjetëra zyrtarë shteti aktivë përditë gjithandej. Hapi i parë i suksesit publik ishte mbledhja e ambasadorëve në Këshillin e Evropës më 24 prill 2023, hapi i dytë ishte dje në mbledhjen e Komitetit për Çështje Politike, hapi i tretë do të jetë Asambleja Parlamentare më 18 prill 2024 dhe i fundit ai i anëtarësimit një muaj më pas, në maj, në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të vendeve anëtare. Falënderoj të gjithë ata të cilët u angazhuan e kontribuuan që në këtë pranverë të bëhemi anëtar të Këshillit të Evropës, e në veçanti falënderoj zëvendëskryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla-Schwarz, zëvendësministrin, Kreshnik Ahmeti, grupin e deputetëve të kryesuar nga nënkryetarja e Kuvendit Saranda Bogujevci, dhe ambasadorin tonë në Strasbourg, Lulzim Hiseni. E arritur e madhe për popullin dhe shtetin tonë, mundësi e re për qytetarët e Kosovës pa dallim. Vlerat themeltare të Këshillit të Evropës, pra demokracia, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut, i vijnë e i rrinë natyrshëm qeverisjes sonë të mirë e progresiste", ka shkruar Kurti në "Facebook".

## MAPL-ja ndan mbi 8 milionë euro për 11 komuna

Prishtinë, 28 mars - Ministri i Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL), Elbert Krasniqi, ka bërë me dije se janë ndarë 8 milionë euro për 11 komuna të Kosovës. “Me kryetarët e komunave përfituese nënshkruam marrëveshjet në kuadër të Grantit të Performancës Komunale. Komunat përfituese janë Rahoveci, Obiliqi, Skënderaj, Suhareka, Kaçaniku, Shtimja, Malisheva, Dragashi, Ranillugu, Parteshi dhe Peja. Projektet në komunat përfituese janë bashkëfinancim i MAPL-së, donatorëve dhe komunave në vlerë mbi 8 milionë euro. Në kuadër të këtij bashkëfinancimi janë paraparë projekte për rregullimin e shtratit të lumenjve, pastrimin e shtratit të lumit, ndërtimin e fushave sportive, rregullimin e ndriçimit publik dhe projekte të tjera të cilat kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët dhe rritjen e zhvillimit ekonomik lokal”, ka thënë Krasniqi.



# Përkujtohen viktimat e familjeve Bogujevci, Duriqi dhe Llugaliu

Podujevë, 28 mars - Në përvjetorin e 25-të të masakrës së kryer në Podujevë nga njësiti serb “Skorpionët”, kryeministri Albin Kurti bëri homazhe te varrezat e të vrarëve të familjeve Bogujevci, Duriqi dhe Llugaliu.

Sikurse ishin të bashkuara familjet Bogujevci, Duriqi dhe Llugaliu, kryeministri tha se njësoj të bashkuar jemi edhe ne sot në kujtim dhe në nderim të rënies së tyre për tokën e Kosovës dhe për lirinë e popullit. “Ata na e kujtojnë dhe përkujtojnë se sa i lartë ishte çmimi i shtetit dhe lirisë që e gëzojmë sot, se si rrënjët e shtetit dhe të lirisë janë te gjaku i martirëve dhe dëshmorëve. Njëkohësisht, zëri



ynë do të jetë gjithnjë më i fuqishëm si institucional ashtu edhe qytetar për kërkim të drejtësisë”, theksoi kryeministri.

Në mesin e të mbijetuarve të kësaj masakre, kryeministri përmendi Saranda Bogujevcin, tashmë deputete dhe nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila bashkë me të mbijetuarit e tjerë u bënë ballë breshërive të plumbave dhe të cilët sot janë ndër dëshmitarët e gjenocidit të Serbisë në Kosovë.

Duke i dhënë theks nevojës për drejtësi institucionale në Kosovë dhe në rajon, kryeministri Kurti vazhdoi duke i bërë thirrje edhe një herë Prokurorisë në Kosovë të punojë për ndjekjen e kriminelëve dhe vënien e drejtësisë, e cila do të finalizohej me vënien prapa grilave të vrasësve mizorë të familjeve Bogujevci, Duriqi e Llugaliu.

Ngjashëm u shpreh edhe Enver Duriqi, të cilit në këtë masakër iu vranë katër fëmijë të moshave 3, 5, 8 edhe 10 vjeç, bashkë me gruan dhe prindërit. “Është mbajtur një gjykim sa për sy e faqe dhe kisha me quajt se ata i kanë metodat e veta, injorojnë, nuk gjykojnë, nuk i pranojnë krimet por, si do që të jetë, ne do të qëndrojmë edhe më të fortë”, deklaroi Duriqi.

Bashkë me kryeministrin Kurti të pranishëm për t’i kujtuar viktimat e kësaj masakre ishin edhe zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, si dhe zëvendësministra dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës.

# MKRS-ja jep Çmimet Vjetore për Teatër

Prishtinë, 28 mars - Në Ditën Botërore të Teatrit, në Amfiteatrin e Teatrit Kombëtar të Kosovës në Pallatin e Rinisë është mbajtur ceremonia e ndarjes së Çmimeve Vjetore për Teatër 2023.

Ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, bazuar në vlerësimin e jurisë profesionale, çmimin për shfaqjen më të mirë ia dha regjisorit francez Igor Mendijsky për shfaqjen “1984”, Teatri Kombëtar i Kosovës.

Çmimi për vepër jetësore post-mortem artistit të madh Muharrem Qena.

Çmimin për regjinë më të mirë regjisorit Fadil Hysaj për shfaqjen “Fausti”, Teatri Kombëtar i Kosovës, Teatri Bekim Fehmiu Prizren, Teatri i Qytetit Gjilan.

Çmimin për aktorin/aktoren më të mirë Adrian Morinës për dy role në shfaqjet “1984” dhe “Fausti”.

Çmimi për prezantim të suksesshëm ndërkombëtar iu dha “Qendrës Multimedia”.

Pjesë e jurisë profesionale në këtë edicion ishin: Kushtrim




Koliqi, Ag Apolloni, Ilir Bokshi, Doruntina Basha dhe Ernest Malazogu.

Ministri Çeku në fjalën e tij i ka uruar laureatët e çmimeve, duke theksuar se “MKRS-ja dhe qeveria u është falënderues të gjithë atyre që përbëjnë komunitetin teatror, nga ata të cilët na bie t’i shohim më shpesh, aktorët/et në skenë, skenaristët, regjisorët, dramaturgët dhe ekipet e tjetra profesionale e deri te pjesa që i shohim më pak, por që janë shumë të rëndësishëm ata që qëndrojnë prapa skenave të cilët e bëjnë të mundur magjinë e teatrit”.

# Fillon projekti madhor 2.4 milionë euro në Gjilan

Gjilan, 28 mars - Kanë filluar punimet e njërit ndër projektet më të mëdha në Gjilan. Është fjala për zgjerimin e rrugës “Hamdi Kurteshi” në vlerë prej 2.4 milionë eurosh.

Kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, i shoqëruar edhe nga drejtori për Shërbime Publike, Infrastrukturë e Banim, Mentor Mihovci dhe ai për Mbrojtje dhe Shpëtim, Bejtullah Osmani, si dhe përfaqësues të Forcës së Sigurisë, kanë parë nga afër nisjen e punimeve. “Projektet nga prezantimi 7 javë - 7 projekte po marrin jetë”, tha



Hyseni.

I pari i komunës tha se pas sezonit dimëror, tash janë krijuar kushtet për vazhdim të punimeve. Ky projekt është një nga rrugët më të frekuentuara dhe më të rëndësishme për hyrje-dalje nga Gjilani. “Si një nga projektet më të mëdha kapitale, ky projekt do ta zgjerojë infrastrukturën e qytetit dhe do ta përmirësojë dukshëm jetën e qytetarëve. Për Gjilanin që duam”, tha Hyseni.

Kryetari i Gjilanit tha se punimet kanë filluar brenda kazermës së FSK-së për ta ndërtuar murin e perimetrit të parë të sigurisë. Sipas Hysenit, në fund të muajit prill dalin jashtë këtij perimetri dhe vazhdojnë punimet në hapësirën e jashtme. Kjo pjesë përgjatë Kazermës së FSK-së do të ketë rrugë me katër krosi, trotuar në dy anët, shteg për biçikleta, infrastrukturë nëntokësore (përfshirë edhe zhvendosjen e kabllove elektrike në kanale nëntokësore), apo mbulimi i lumit Stanishorka.

Punimet pritet të përfundohen brenda vitit 2024.

Ky projekt, me bashkëfinancim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ishte paraqitur më 22 janar të këtij viti në kuadër të projekteve me moton “7 javë - 7 projekte”, ndërsa gurthemeli ishte vënë më 1 dhjetor, ku ishte edhe kryeministri Albin Kurti.

## Tri çerdhe për fëmijë në Rahovec pajisen me inventar

Rahovec, 28 mars - Ka filluar pajisja me inventar e tre çerdheve për fëmijë të cilat janë ndërtuar dhe presin të funksionalizohen. “Furnizimi me inventar dhe montimi filloi në çerdhen e fëmijëve në Krushë të Madhe dhe gjatë ditëve të ardhshme do të vazhdojë edhe në dy çerdhet tjera të ndërtuara nga Komuna e Rahovecit, në Xërxë dhe Ratkoc”, ka njoftuar komuna e Rahovecit.



# PDK-ja bëhet me kryesi të re, Bedri Hamza emërohet nënkryetar

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të enjten ka votuar kryesinë e re në të cilën ka emëruar kryetarin e Mitrovicës, Bedri Hamzën, nënkryetar të kësaj partie. Në kryesinë e re, Vlora Çitaku është emëruar sekretare e përgjithshme, Uran Ismaili ka mbetur nënkryetar, Agim Aliu, Shaqir Totaj, Besianë Musmurati, Mimoza Ahmetaj, po ashtu, kanë marrë pozitën e nënkryetarëve




EPOKA E RE Mal QORRAJ

**Prishtinë, 28 mars** - Këshilli Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës, me ftesë të kryetarit Memli Krasniqi, ka mbajtur të enjten mbledhjen e radhës, në të cilën është diskutuar për zhvillimet e fundit politike në vend dhe ato brendapartiake.
Në kuadër të vendimit të fundit të Këshillit Drejtues për fillimin e organizimit për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, PDK-ja ka vazhduar mobilizimin e tërë potencialit të saj në të gjitha nivelet e organizimit partiak.
Për t'i sjellë vendit, pas zgjedhjeve të ardhshme, një qeveri kredibile, të përgjegjshme dhe e cila rikthen vendin në kursin e duhur të zhvillimit, mirëqenies dhe integrimit euroatlantik, kryetari Krasniqi tashmë ka nominuar edhe zyrtarisht Bedri Hamzën kandidat të Partisë Demokratike të Kosovës për kryeministër të vendit.
Kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, ka marrë mbështetjen e plotë të Këshillit drejtues të partisë në këtë mision fisnik dhe të rëndësishëm për shtetin dhe qytetarët.
Si pjesë të rëndësishme për rritje dhe fuqizim të partisë janë edhe aderimet e kuadrove të ri profesional të cilët tashmë kanë filluar t'i bashkohen PDK-së e do të vazhdojnë edhe më tej në ditët në vijim, siç ishte rasti me gjenerallejtënant Rrahman Rama.
Ndërkohë, në vazhdën e këtij mobilizimi, Këshilli Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës ka miratuar të enjten edhe riorganizimin e kryesisë së partisë.
Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se kjo rritje e dinamikës së punës dhe vendimeve të rëndësishme partiake është pjesë e krijimit të ofertës më të mirë për qytetarët, për ta rikthyer besimin e tyre dhe për t'i dhënë vendit, pas zgjedhjeve, një qeveri të re që e rikthen Kosovën në binarët e zhvillimit, integrimit dhe perspektivës për të gjithë.
"Bedri Hamza është kryeministri që sot i duhet Kosovës. Sot është koha për të mbledhur në një vend të gjitha potencialet e vendit tonë, për t'i dhënë Kosovës një qeveri të re, kompetente, vizionare dhe që mendon për secilin qytetar. Një qeveri që udhëheq me modesti e pa arrogancë, me frymë ekipore dhe gjithëpërfshirëse. Dhe në këtë drejtim, do të bashkëpunojmë me të gjithë ata që dëshirojnë t'i japin Kosovës një drejtim të ri" ka thënë Krasniqi.
Ndërsa kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, para anëtarëve të Këshillit Drejtues, ka thënë se beson në forcën dhe fitoren e PDK-së. "Ky është nderi më i madh në jetën time, rrjedhimisht, përgjegjësia më e madhe në jetën time. Falënderoj kryetarin Krasniqi për besimin dhe të gjitha strukturat e partisë për mbështetjen. Sot para jush dhe para qytetarëve të Kosovës ju them se jam tërësisht i gatshëm që të zotohem se, me të gjitha kapacitetet e mia profesionale dhe personale, do ta jap maksimumin për suksesin e PDK-së në zgjedhjet e përgjithshme. Unë besoj në forcën e PDK-së. Unë besoj në fitoren e PDK-së", ka thënë Hamza.
Gjatë kësaj mbledhje Këshilli Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës i ka dhënë mbështetjen e parezervë kryetarit Krasniqi, kryesisë, grupit parlamentar dhe të gjitha strukturave të tjera partiake, për ta ofruar alternativën më të mirë qeverisëse e cila nxjerr vendin nga pozicioni i pafavorshëm në të cilin ndodhet.
Në mbledhjen e Këshillit Drejtues është thënë se Kosova ka nevojë për zgjedhje të përgjithshme të parakohshme, sa më parë, për t'i dhënë vendit një qeveri të re, kredibile dhe zhvillimore.

### KRYESIA E RE E PDK-së

Memli Krasniqi, kryetar
Vlora Çitaku, sekretare e përgjithshme
Bedri Hamza, nënkryetar
Uran Ismaili, nënkryetar
Agim Aliu, nënkryetar
Shaqir Totaj, nënkryetar
Besianë Musmurati, nënkryetare
Mimoza Ahmetaj, nënkryetare
Bajrush Xhemaili, sekretar për politika programore
Abelard Tahiri, sekretar për organizim dhe zgjedhje
Bernard Nikaj, sekretar për marrëdhënie ndërkombëtare
Betim Gjoshi, sekretar për anëtarësi dhe financa
Enver Hoxhaj
Rrahman Rama
Jakup Nura
Sokol Bashota
Evgjeni Thaçi - Dragusha
Nexhat Demaku
Besa Kabashi - Ramaj
Zenun Pajaziti
Valdete Idrizi
Elmi Reçica
Mërgim Lushtaku
Ferat Shala
Fehmi Mujota
Petrit Hajdari
Eliza Hoxha
Ganimete Musliu
Blerta Deliu - Kodra
Ariana Musliu - Shoshi
Floretë Zejnullahu
Blerand Stavileci
Luljeta Veselaj - Gutaj
Muhamet Haliti
Kujtim Gashi
Safete Hadërgjonaj
Genc Prelvukaj
Kurtan Kajtazi
Bekim Azizi
Përparim Gruda
Arben Mustafa
Aurora Osmani - Buca
Arbnora Salihu, kryetare e RDK-së
Adri Nurellari, drejtor i Institutit për Studime dhe Analiza
Naim Ismajli, drejtor ekzekutiv i PDK-së

Reagim i KMDLNj-së

# Të sëmurët me kancer, në mëshirën e askujt!

Doli një informatë se Ministria e Shëndetësisë ka ndarë nga një milion euro në muaj për trajtim të qytetarëve të Kosovës jashtë vendit e që për KMDLNj-në është shifër e papërfillshme krahasuar me nevojat e të sëmurëve që nuk kanë kushte për trajtim në institucionet shëndetësore kosovare. Mungesa e Ligjit për Sigurime Shëndetësore, që ende nuk po zbatohet në Kosovë po e rëndon dhe pamundëson trajtimin profesional të pacientëve me probleme të rënda shëndetësore. Në këtë kontekst, të sëmurët me kancer të diagnostifikuar janë në pozitë shumë të rëndë. Klinika onkologjike, me kapacitetin që e ka, profesional dhe material nuk është në gjendje t'i përmbushë




nevojat e këtyre të sëmurëve. Siç i kanë deklaruar KMDLNj-së, të sëmurët me kancer dhe familjarët e tyre, trajtimi është shumë i kushtueshëm dhe për shumicën absolute është i papërballueshëm. Trajtimi për 14 - 18 ditë kushton 1400 deri në 1800 euro ndërsa drejtoritë shëndetësore komunale mund të ndajnë, në rastin më të mirë 700 euro brenda një viti kalendarik për shkak të mungesës së mjeteve. Klinika Onkologjike, sipas këtyre pacientëve, përkundër përpjekjeve që i bënë, nuk ka mundësi të sigurojë këto barna shumë të kushtueshme ndërsa Ministria e Shëndetësisë, përveç premtimeve të vazhdueshme ende nuk ka marrë asnjë veprim të tejkalojë këtë situatë.
Pacientët e tillë, në pamundësi të krijojnë mjete vetjake, për trajtim detyrohen të hyjnë në borxhe, të marrin kredi, të kërkojnë ndihma nga bamirësit apo të shesin prona.
Kujdesi shëndetësor për qytetarët e Kosovës është përgjegjësi e shtetit i cili ka dështuar në këtë aspekt ndonëse ka mjete të mjaftueshme financiare. Sigurimi i trajtimit shëndetësor në përputhje me nevojat e këtyre pacientëve është pjesë fundamentale e të drejtave të njeriut që garantohen me të gjitha dokumentet ndërkombëtare dhe ndërkombëtare për këto të drejta që nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara e deri te Kushtetuta e Kosovës. Pacientët me kancer në Kosovë jo që nuk po trajtohen në përputhje me të drejtat e njeriut që iu takojnë por as edhe çastet e fundit të jetës nuk po i kalojnë në mënyrë të dinjitetshme. Deputetët e Kuvendit të Kosovës asnjëherë nuk kanë hapur debat për këtë çështje duke përligjur një dukuri diskriminuese ku trajtimi bëhet në bazë të fuqisë materiale dhe statusit në shoqëri!

## Gjatë shkurtit mërgata dërgoi në Kosovë rreth 88 milionë euro



PRISHTINË, 28 MARS - Rreth 88 milionë euro është vlera preliminare e dërgesave të mërgatës që janë sjell në Republikën e Kosovës për muajin shkurt 2024. Kështu thuhet në statistikat e remitancave dhe institucioneve të tjera financiare për këtë periudhë, të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), duke shtuar se vlera totale e tyre, sipas vlerësimeve preliminare, ka arritur në 174.3 milionë euro. Sipas raportit, prurjet më të mëdha të remitancave ishin nga institucionet financiare jobankare me pjesëmarrje prej 64.4-përqindësh, pasuar nga kanalet e tjera me 19.7 për qind dhe bankat me 15.9 për qind.
Për sa iu përket aseteve të kompanive të sigurimit, BQK-ja tregon se deri në këtë muaj vlera e tyre ishte 312.7 milionë euro, duke shënuar rritje rreth 600 mijë euro krahasuar me janarin e 2024-s.
Asetet e fondeve pensionale kanë arritur vlerën e 2.8 miliardë euro, e cila përfaqëson rritje për 46.5 milionë euro.
Në fund, BQK-ja tregon se asetet e ndërmjetësve të tjerë financiarë në fund të muajit shkurt 2024 janë rritur për 15.1 milionë euro, duke arritur vlerën e 555.2 milionë eurove.

# Oda Amerikane shënoi 20-vjetorin e themelimit, Hovenieri thekson kontributin në zhvillimin ekonomik të Kosovës

PRISHTINË, 28 MARS - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shënoi njëzetvjetorin e themelimit me një pritje ku morën pjesë mysafirë dhe personalitete të shquara, përfshirë anëtarët themelues. Me këtë rast, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, theksoi arritjet dhe kontributin e rëndësishëm të Odës Amerikane në zhvillimin ekonomik të Kosovës.
Duke reflektuar mbi rrugëtimin e Odës Amerikane që nga themelimi i saj në vitin 2004, ambasadori Hovenier nënvizoi rritjen e saj të jashtëzakonshme nga 21 anëtarë themelues në një komunitet prej 260 anëtarësh sot.
Ai vlerësoi qëndrueshmërinë dhe adaptueshmërinë e organizatës, veçanërisht gjatë kohërave sfiduese siç ishte pandemia e fundit, ku Oda Amerikane demonstroi përkushtimin e saj duke kaluar me shpejtësi në platformat virtuale dhe duke organizuar mbi 100 ngjarje online, thuhet në komunikatë.
Duke folur për mjedisin ekonomik të Kosovës, ambasadori Hovenier theksoi potencialin për tregti dhe investime, duke iu referuar edhe sfidave ekzistuese.
Ai lavdëroi Odën Amerikane për përpjekjet e saj avokuese në angazhimin me qeverinë për adresimin e këtyre shqetësimeve, duke riafirmuar mbështetjen e palëkundur të Shteteve të Bashkuara për rritjen dhe prosperitetin ekonomik të Kosovës.
Duke folur për të ardhmen, ambasadori Hovenier artikuloi dy aspirata kyçe për Odën Amerikane dhe anëtarët e saj. Së pari, ai inkurajoi promovimin më të madh të iniciativave të përgjegjësisë sociale korporative, duke mirënjohur ndikimin pozitiv



të bizneseve në shoqërinë dhe ekonominë e Kosovës. Së dyti, ai theksoi rëndësinë e diversitetit, barazisë dhe gjithëpërfshirjes brenda Odës Amerikane, duke u kërkuar anëtarëve të angazhohen për përfaqësim dhe gjithëpërfshirje më të madhe.
Në përfundim, ambasadori Jeffrey Hovenier shprehu optimizmin për të ardhmen e Odës Ekonomike Amerikane, duke u kërkuar anëtarëve ta vazhdojnë punën e tyre shembullore për një organizatë që është kampione e përgjegjësisë sociale, rritjes gjithëpërfshirëse dhe e cila fuqizon pozitën e Kosovës në ekonominë globale, thuhet në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.

# ZKA-ja auditon shitjet direkte të AKP-së



PRISHTINË, 28 MARS - Në kuadër të zbatimit të Planit Vjetor të Auditimit 2023/2024, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është duke realizuar auditimin e performancës "Vlerësimi i Procedurave të Shitjes Direkte të Aseteve nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit" për periudhën 2019-2021.
Shitjet direkte të realizuara që nga viti 2006 (dhe në vazhdim) u takojnë natyrave të ndryshme si: objekte, toka dhe asete të luajtshme, të cilat gjenden në lokacione të ndryshme dhe kanë vlera të ndryshme.
Ky auditim do të vlerësojë nëse procedurat e shitjes direkte të aseteve nën menaxhim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) janë realizuar në mënyrën e duhur, përkatësisht nëse AKP-ja ka qenë efikase në trajtimin e kërkesave për shitje direkte, në trajtimin dhe klasifikimin e aseteve për shitje direkte, si dhe në mënyrën se si është bërë përzgjedhja e vlerësuesve për përcaktim të vlerës së aseteve.
Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore, rëndësinë që ka ky proces për përmbylljen e likuidimit të ndërmarrjeve si dhe mjedisin në përgjithësi, ZKA-ja vlerëson se është me interes për publikun të bëhet një vlerësim nëse procedurat lidhur me shitjet direkte janë realizuar si duhet. AKP-ja vazhdon të përballet me kërkesa për blerje të aseteve të cilat janë apo mund të jenë në shfrytëzim të palëve të treta, dhe në këtë rast pamundësohet shitja e tyre përmes procedurës së tenderimit publik.
Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) përmes këtij auditimi synon ta bëjë vlerësimin e gjendjes si dhe nëse AKP-ja ka qenë efektive në menaxhimin e shitjeve direkte, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij procesi, interesin publik si dhe ndikimin e tyre në mjedisin shoqëror dhe ekonomik.

## "FMN-ja vlerëson lart performancën e institucioneve të Kosovës"

PRISHTINË, 28 MARS - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur në takim një delegacion nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, kryesuar nga shefi i ri i këtij misioni për Kosovë, Sebastian Sosa, e ku prezent ishte edhe ai paraprak, Gabriel di Bella.
Qeveria ka njoftuar se në takim u theksua bashkëpunimi i frytshëm dhe i shkëlqyeshëm me FMN-në dhe vazhdimësia e tij. "Nga FMN-ja u vlerësua lart performanca e institucioneve të Kosovës lidhur me reformat e ndërlidhura me marrëveshjet në mes të Kosovës dhe FMN-së. Aktualisht po punohet intensivisht e për së afërmi me institucionet relevante lidhur me projektet në energji, me theks të veçantë ato në energjinë e ripërtërishme. U trajtuan edhe rezultatet pozitive dhe performanca e Kosovës në indikatorët kryesorë makroekonomikë, ku edhe pritet që trendi të vazhdojë të jetë pozitiv në krahasim edhe me shtetet e tjera të rajonit", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



# DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (13)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-58-
**Për përdorim të kufizuar**

Ambasada britanike
Beograd
J C R Gray Esq
EESD
FCO
17 qershor 1981
I nderuar Charles,

**Kosova: emigrimi i serbëve dhe malazezëve**

1. Siç e kam përmendur në letrën time për Kosovën javën e kaluar, këtu është shprehur shqetësimi zyrtar për "pasiguri" në mesin e serbëve dhe malazezëve në Krahinë dhe për efektet e dëmshme të emigrimit të tyre. Megjithëse ka pasur një qarkullim të qëndrueshëm të emigrantëve për disa vite deri më sot, vetëm kohët e fundit janë shfaqur komente kritike zyrtare dhe të shtypit në drejtim të trazirave aktuale.
Shifrat e censusit
2. Siç e ka përmendur edhe Jon Ward në letrën për ju, më 13 maj, në konferencën e tij kryesore për shtyp, Dolanc ka mohuar me forcë ekzistencën e një migracioni të dukshëm të serbëve dhe malazezëve nga Kosova. Për të qenë i saktë, Dolanc tha se "duke parë profilin e popullsisë në terma përqindjeje, përqindjet nuk kanë ndryshuar shumë gjatë 20 viteve të fundit, megjithëse nuk e mohoj se ka pasur disa raste të tilla". Meqenëse censusi është plotësuar vetëm në Kosovë më 20 prill dhe rezultatet e tij u publikuan në fillim të majit, vlerësimi i Dolanc ishte i nxituar dhe, siç rezultoi, tërësisht i gabuar. Kështu, siç tregoi letra e Jon, gjatë dhjetë viteve të fundit numri total i serbëve në Kosovë ka rënë me 8.1%, ndërsa numri total i malazezëve ka rënë jo më pak se 14.8%. Në vitin 1961 njerëzit që e deklaronin veten si serbë përfaqësonin 23.5% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës; në vitin 1971 ata përbënin 18.4% dhe në vitin 1981 përbënin 13.2% (shifrat për malazezët janë respektivisht 3.9%, 25% dhe 1.7%). Me fjalë të tjera, megjithëse midis viteve 1961 dhe 1981 popullsia e përgjithshme zyrtare e serbëve ra vetëm me 17,000 diferenca ndërmjet numrit të atyre që jetojnë në Kosovë me ata që do të kishin jetuar aty sipas normave të zakonshme jugosllave të rritjes dhe pa emigrimin, është shumë më e theksuar. Në terma si absolute dhe relative, numri i serbëve dhe malazezëve që jetojnë në Kosovë ka rënë dukshëm që prej vitit 1971.
Deklaratat zyrtare
3. Ndërkohë që vendimet individuale për t'u larguar nga Kosova nuk mund të kritikoheshin zyrtarisht, tendenca në përgjithësi është dënuar nga autoritetet; gjithashtu janë bërë premtime për masa të forta kundër kujtdo që ushtronte "presion" për të nxitur emigrimin. Kështu, më 1 qershor, Jusuf Kelmendi, anëtar i Konferencës së Lidhjes Socialiste të Kosovës, tha se ishte detyrë konkrete për të shqyrtuar në detaj motivet për secilin vendim individual për të emigruar. "Duhet të merren masa më aktive politike dhe ligjore" kundër atyre që ushtrojnë presion. Më 4 qershor, Petar Kostiç, sekretari i Komitetit Krahinor të LKJ-së, tha se ishte e nevojshme për "ndërhyrje urgjente" për të ndaluar largimin e serbëve dhe malazezëve. Azem Vllasi, kryetar i Lidhjes Socialiste të Kosovës, tha në konferencën e tij për shtyp, më 6 qershor, se pas demonstratave është krijuar një situatë e cila "në mënyrë objektive dha pamjen e presionit". Ai vazhdoi: "në këtë situatë çdo migracion ka një ngjyrë politike që krijon me shpejtësi një ndikim të pakëndshëm veçanërisht për ata njerëz që kanë ndërmend të jetojnë gjithë jetën e tyre në këtë Krahinë". Dhe më 10 qershor, Mustafa Ristiç, kryetar i Seksionit të LKJ-së të Lidhjes Socialiste të Kosovës, tha se raportimi nga ana e shtypit për Kosovën nuk ka kontribuar gjithmonë në qetësimin e gjërave, veçanërisht për sa i përket emigrimit të serbëve dhe malazezëve, të cilët i janë nënshtruar presionit për të shitur shtëpitë e tyre dhe për t'u larguar. "Publikimi i vazhdueshëm i fotografive të dominuara nga tabelat ku thuhet "Shtëpi për shitje" nuk po ndihmojnë për të ndaluar emigrimin. Po të isha serb, do të kërkoja një blerës për shtëpinë time pasi të shihja kaq shumë foto". Rishtiç shtoi se "asnjë shqiptar në Kosovë nuk mund të ndjehet i sigurt nëse serbët dhe malazezët nuk ndjehen në të njëjtën mënyrë". (!) Siç mund ta kuptoni, prononcime të tilla janë zakonisht të gjata në denoncime dhe të shkurtra në sugjerime konkrete.
Presioni për të emigruar
4. Siç e tha Ristiç, shtypi ka gjetur mbështetje në këtë çështje. Gazetat "NIN", "Duga" dhe "Ilustrovana Politika", kanë pasur të gjitha artikuj me intervista dhe foto personale të shtëpive me njoftimet "Për shitje" (për interesin tuaj, bashkëlidhur po ju dërgoj një kopje të një faqeje të tillë nga gazeta "NIN" e datës 7 qershor për këtë çështje). Siç e tha gazeta "NIN", "çështja e presionit është delikate. Nëse e kufizoni atë me shkatërrimin e gjerë të pronës, keqtrajtimin fizik, kërcënimet serioze për jetën dhe i zbatoni këto kërcënime - ndoshta presioni nuk ndodh shpesh. Por, nëse ju gjithashtu i shikoni vështirësitë në rritje për punën, promovimin ose shkollimin si forma të presionit, nëse në mënyrë të ngjashme i klasifikoni aktet e vogla sistematike të mërisë për të cilat normalisht fajtorë janë fëmijët, por edhe të rriturit; dhe nëse shtoni sulmet ndaj monumenteve kulturore, abuzimin e femrave në rrugë, diskriminimin në punë dhe gjëra të tjera të vogla dhe të mëdha, atëherë do të gjeni mjaft presion për të shqetësuar një person, për ta bërë të ndjehet i trazuar dhe të dëshirojë të gjejë paqe dhe qetësi diku tjetër".
5. Për të sjellë shembuj, këtu ka disa fragmente nga artikulli i gazetës "Duga" për historinë personale të Aleksandër Milloshevicit, i cili u largua nga Kosova në vitin 1970, duke lënë pas një fermë mjaft të madhe. "Për të gjithë parcelën unë mund të merrja - jo, më mirë të mos e them". Familja e tij përbëhej nga 17 anëtarë dhe disa ishin të armatosur. Por më kot. Disa fshatarë shqiptarë kanë nxjerrë bagëtitë e tyre nëpër fusha dhe e kanë shkatërruar parcelën. Kur ai u ankua në polici ata i thanë se kishin qenë fëmijë ata që e kishin bërë këtë, apo një shaka praktike. Femrat duhej të shoqëroheshin kur dilnin jashtë. Varret e tyre ishin dhunuar. "Nëse do përpiqeshit të bëni padi, atëherë fajtori do të ishit ju. Ju quajnë "Nacionalist". Nëse shefi i policisë do të më pyeste, unë do t'i thosha: "U largova për shkakun tuaj - Ju mbrojtët ato grupe që po sulmonin njerëz të tjerë"." Shumë njerëz ishin larguar vetëm me një çantë në shpinë dhe fëmijët e tyre në krahë. Në dyert e tyre u gjetën shënime të tilla si "Shansi i vetëm për t'u larguar - rruga Krushevac, Kraljevo, Smederevo, Gornji Milanoviç ... puthni pragun e shtëpisë tuaj dhe largohuni".
Komente
6. Është e tepërt të thuhet se do të jetë pak a shumë e pamundur që autoritetet të ndalojnë përndjekjet në shkallë të vogël apo letrat kërcënuese anonime. Rritja e shpejtë e popullsisë shqiptare dhe ulja e numrit të serbëve jepnin një tablo alarmuese për të ardhmen e Kosovës në afat të mesëm apo të gjatë; dhe, siç e thashë javën e kaluar, largimi i punëtorëve të kualifikuar ka implikime ekonomike serioze të menjëhershme. Sidoqoftë, për sa kohë që vetë Shqipëria ndjek vijën e saj të përgjithshme aktuale nuk ka arsye të imagjinohet se ky problem emigrimi ka shansin më të vogël që të zgjidhet.
I Juaji,
Charles Crawford
Oficer Informacioni
Për dijeni: P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

-59-
**Konfidenciale**
23 qershor 1981
Z. Bullard,

**Situata në Jugosllavi**

1. Keni kërkuar vlerësimin tonë mbi kontributin grek në COREU ngjitur.
2. Kjo është një pjesë e mirë e cila në shumë drejtime kombinohet me raportimin shumë të hollësishëm që kemi marrë nga Beogradi. Grekët kanë interes të ngushtë dhe të mirinformuar në çështjet e Ballkanit dhe zhvillimet në Kosovë (një pjesë e të cilave janë pasqyruar fillimisht në pretendimet irredentiste greke) paraqesin interes të veçantë për ta.
3. Jemi të një mendimi me vërejtjet e përgjithshme në lidhje me udhëheqjen pas Titos dhe situatën ekonomike. Sidoqoftë, jo për çudi, kjo pjesë përqendrohet në trazirat e fundit në Kosovë. Mendojmë se grekët të cilët janë të merakosur që të shihen si të paanshëm mund të kenë minimizuar mundësinë e përzierjes shqiptare, por jemi dakord me vlerësimin e tyre se nuk ka të dhëna mbi ndërhyrje nga ana e Bashkimit Sovjetik.
4. Kur të drejtojmë grupet e punës të Evropës Lindore në gjysmën e dytë të vitit, duket se është me vlerë që të shqyrtojmë mundësinë për t'i kërkuar grekëve që të ofrojnë më tej kontributin e tyre në çështjet me interes aktual të Ballkanit.

I Juaji,
A. E. Montgomery
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Për dijeni: Z. Broomfield

-60-
**Për përdorim të kufizuar**
NR 2033
EM ATM COPEU
CPE/BIL/ETR 145
Direkt për të gjithë COPEU
Grupi punës së Evropës Lindore

**Situata në Jugosllavi**

a) Situata ekonomike
Për shkak të krizës ekonomike kombëtare në shkallë të madhe, zhvillimi i situatës ekonomike në Jugosllavi është veçanërisht i pafavorshëm. Numri i të punësuarve u rrit në 1.200.000 (800.000 sipas të dhënave zyrtare). Norma e inflacionit, e cila në vitin 1980 ishte 50%, nuk parashikohet që të bjerë ndjeshëm në vitin 1981. Borxhi i jashtëm i vendit u rrit në 18 miliardë dollarë. Vështirësitë ekonomike çuan në rishikimin e programit ekonomik dhe zhvlerësimin e dinarit me 30% në mesin e vitit 1980.
b) Çështja e kombësive
1) Të përgjithshme
Një prej problemeve më serioze me të cilat përballet udhëheqja post-Tito është ajo e pretendimeve të kombësive dhe pakicave (kroatët, sllovenët, maqedonasit, myslimanët, shqiptarët etj.), të cilat përbëjnë Republikën Federative të Jugosllavisë. Këto pretendime (të cilat janë nënvizuar nga pabarazia ekonomike midis krahinave të varfra dhe atyre të pasura) padyshim u bënë më këmbëngulëse pas vdekjes së Titos i cili falë personalitetit të tij të fuqishëm, ia doli me sukses që të ruante unitetin e mozaikut shumëkombësh të vendit të tij.
Komuniteti shqiptar i Kosovës (1.200.000) përbën shumicën dërrmuese (80%) të popullsisë së rajonit. Ngjarjet e fundit aty çuan në krizën e parë të madhe nacionaliste në Jugosllavi, pas vdekjes së Titos.
2) Incidentet në Kosovë
A. Fakte
Tablloja e Prishtinës, më 11 dhe 26 mars, vijoi më 1 prill me demonstrata masive. Kërkesa kryesore e demonstruesve ishte që ta bënin Krahinën Autonome të Kosovës Republikë të shtatë socialiste, të barabartë me gjashtë republikat e tjera. Megjithatë, kishte gjithashtu parulla në favor të "bashkimit me atdheun".
Autoritet jugosllave reaguan në mënyrë veçanërisht tronditëse duke dërguar ushtrinë dhe forcat e policisë pas demonstruesve, ku shumë njerëz u vranë dhe u plagosën. Kosova u deklarua zonë emergjente dhe për të huajt u ndalua hyrja në këtë Krahinë. Shumë persona u arrestuan dhe u morën masa të rënda, në veçanti kundër profesorëve, studentëve dhe mësuesve.
Sipas të dhënave zyrtare jugosllave, 287 persona u dënuan për pjesëmarrje në demonstrata, 189 të tjerë u pushuan nga puna dhe 442 anëtarë të LK-së lokale u shkarkuan, përfshirë Bakallin, kryetar i Komunistëve të Kosovës. Për më tepër, u bllokua bashkëpunimi arsimor dhe kulturor midis Kosovës dhe Shqipërisë.
Autoritetet e Kosovës akuzuan Shqipërinë se kishte organizuar aktivitete subversive kundër Jugosllavisë.
Shtypi shqiptar mbështeti hapur kërkesat e demonstruesve dhe akuzoi Jugosllavinë se kishte shfrytëzuar elementin shqiptar. Sipas kundërsulmit të shtypit jugosllav, kjo përbënte një kërcënim ndaj integritetit territorial të vendit.
Tensioni midis dy vendeve u përshkallëzua kur, më 23 maj, në Ambasadën jugosllave në Tiranë shpërtheu një bombë, ndërkohë që qeveria hodhi poshtë protestën jugosllave.
3) Vlerësime
Me gjithë polemikat e egra midis dy fqinjëve, nuk ka prova të prekshme se Shqipëria ka përkrahur trazirat në Kosovë. Për më tepër, fakti që shtypi shqiptar filloi të mbështeste kauzën e demonstruesve plot një javë pas trazirave, sugjeron më tepër se shqiptarët u zunë në befasi dhe se shkaqet e trazirave ishin të brendshme. Ky konkluzion ka të ngjarë që të përforcohet nga fakti se, disa muaj pas trazirave Kosova është ende në gjendjen e ndalimqarkullimit. Për më tepër, kushdo mund të vërejë se qëndrimi shqiptar është shprehur vetëm nga lajmet në media dhe se asnjë zyrtar i qeverisë nuk bëri asnjë deklaratë përkatëse. Përkundrazi, disa zyrtarë jugosllavë përdorën një gjuhë mjaft të fortë kundër fqinjëve të tyre, gjithsesi pa shkuar shumë larg që të mos rrezikonin në mënyrë permanente marrëdhëniet midis dy vendeve.
Siç duket, dy vendet nuk dëshirojnë që t'i shtyjnë gjërat në ekstrem... Jugosllavia për shkak të frikës së saj se një Shqipëri plotësisht e izoluar, mund të kërkojë pas periudhës së Enver Hoxhës mbrojtjen e sovjetikëve dhe Shqipëria nga ana e saj, për shkak të nevojës së saj jetësore që të mbulohej nga një shtet politikisht i qëndrueshëm tampon kundrejt BRSS-së.
Nga ana tjetër, nuk ka tregues se trazirat në Kosovë janë provokuar nga Bashkimi Sovjetik.
Duket e sigurt se këto incidente janë shkaktuar nga kushtet e këqija politike dhe ekonomike që kanë mbizotëruar në Kosovë prej shumë vitesh. Aktualisht, Kosova është pjesa më pak e zhvilluar e Jugosllavisë - megjithëse zhvillimi i saj pas luftës ishte impresionues. Raporti i zhvillimit midis Kosovës dhe Kroacisë në vitin 1971 ishte 1:3,2 ndërsa shifra e sotme ka shkuar në 1:7.
Veç kësaj, fakti që kjo krahinë banohet vetëm nga një pakicë josllave në Jugosllavi (përveç hungarezëve të Vojvodinës) e pengoi atë natyrisht për arsye politike që të garantonte statusin e Republikës.
Popullsia shqiptare e Kosovës ka përshtypjen se është e klasit të dytë. Ky fakt së bashku me urrejtjen e tyre kundër Republikës Socialiste të Serbisë, brenda së cilës Kosova përbën një krahinë autonome, i nxiti kërkesat e tyre për pavarësi më të gjerë politike.
Pranimi nga Qeveria jugosllave se Kosova duhet të marrë statusin e Republikës kërkon, gjë që ka pak gjasa, që të marrë parasysh faktin se një veprim i tillë do t'i jepte një goditje poshtëruese Republikës së Serbisë së cilës pas luftës i është shkëputur territori i Republikës Socialiste të Maqedonisë. Ky fakt gjithashtu do të krijonte precedent për Krahinën Autonome të Vojvodinës.
Nga ana tjetër, ngjarjet në Kosovë vërtetuan se sa e gabuar ishte politika e Qeverisë federale për të inkurajuar kontakte të drejtpërdrejta të Kosovës me Shqipërinë veçanërisht në sektorët delikatë të bashkëpunimit

midis universiteteve, programeve kulturore, shkëmbimit të profesorëve etj., duke lejuar kështu që brezi i ri i kësaj krahine të ndërgjegjësohej për origjinën e tij shqiptare.

Në mesin e prioriteteve me të cilat po përballet udhëheqja jugosllave, natyrisht janë... a) rishikimi i sistemit të bashkëpunimit me Shqipërinë dhe i strukturës lokale arsimore me qëllim që të shtypet nacionalizmi shqiptar; b) rishikimi i pushtetit lokal dhe mekanizmit partiak dhe; c) nxitja e menjëhershme dhe liberale e programit të zhvillimit me qëllim që të plotësohen kërkesat ekonomike kryesore të popullsisë.

ATH Copeu
Teksti përfundimtar
[Dërgohen kopje për ambasadat e KE-së në Londër]

**-61-**
**Për përdorim të kufizuar**
Referencë 025/427/1
HofC
G
DA
24 qershor 10981

**Vizita e z. Hesseling të Ambasadës holandeze në Shqipëri**

1. Jan Hesseling raportoi në takimin javor të EC sot (24 qershor) se sapo ishte kthyer nga pritja e lamtumirës së tij në Shqipëri.
2. Gjatë kohës që ishte aty, ai ishte lejuar të lëvizte vetë me makinë dhe për shkak të tabelave të pamjaftueshme rrugore dhe hartës së pasaktë, humbi në dy raste dhe iu desh të kthehej në rrugën e tij pasi arriti në postbllloqe ushtarake. Në një rast, mbi të fluturoi një helikopter, pa dyshim për t'u siguruar se ai nuk ka hyrë në zonën ushtarake.
3. Ai zhvilloi bisedime në Tiranë me zyrtarë shqiptarë të cilët, midis të tjerash, folën për marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare. Shqiptarët thanë se ishte me shumë rëndësi për ta që shqiptarëve të Kosovës t'i jepeshin të drejtat e tyre sipas Kushtetutës Federale jugosllave. Ata thanë se nuk kishin pretendime territoriale, por se ndjenin keqardhje që Fuqitë e Mëdha nuk ia kishin dhënë Kosovën Shqipërisë në vitin 1913. Z. Hessling pyeti për hartën e "Shqipërisë së Madhe" e cila është në qarkullim dhe shqiptarët i thanë se nuk e kishin shpërndarë këtë dhe se një gjë e tillë duhet të jetë bërë nga grupet e emigrantëve të tillë si ballistët apo zogistët. Z. Hesseling raportoi gjithashtu, se shqiptarët i kishin thënë se nuk e kishin idenë se si do të zhvilloheshin marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare dhe se kjo varej shumë nga Jugosllavia. Shqiptarët nga ana e tyre do të dëshironin marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me Jugosllavinë, por me kusht që secili vend të mund të kritikonte tjetrin.
4. Z. Hesseling foli gjithashtu me kolegë të ndryshëm nga misionet e tjera në Tiranë të cilët ishin të mendimit se sulmi i "bombës" kohët e fundit në Ambasadën jugosllave ishte nxitur nga shqiptarët. Diplomatët ishin gjithashtu të mendimit se ngjarjet në Kosovë ishin të dobishme për shqiptarët për të zhvendosur vëmendjen nga problemet e brendshme ekonomike aktuale në vendin e tyre. Ekonomia është në gjendje të dobët dhe shqiptarët e pranojnë se zhvillimi ka qenë i ngadaltë, por vazhdojnë me synimin e tyre për t'u mbështetur tërësisht në burimet e veta. Kongresi i 8-të i radhës pritet që të jetë Kongresi i parë në të cilin plani pesë-vjeçar do të përjashtojë përdorimin e ndihmës apo huas së huaj. Z. Hesseling u ndal në këtë pikë duke thënë se tregtia shqiptare bëhet tërësisht me para dhe se Kushtetuta ndalon specifikisht blerjen e mallrave nga jashtë me kredi. Ai tha se shqiptarët e pranonin që në vitet pas prishjes me Kinën kanë pasur probleme me makineritë dhe automjetet që prisheshin dhe me mungesën e pjesëve të këmbimit me të cilat do t'i riparonin ato dhe se teknologjia në Shqipëri ka mbetur është shumë vite pas. Z. Hesseling tha se marrëdhëniet e Shqipërisë me Kinën janë në nivelin më të ulët të mundshëm, por se misioni kinez, aktualisht i kryesuar nga i Ngarkuari me Punë, kishte mbetur njësoj siç ishte para prishjes me Shqipërinë (sidoqoftë, Lista Diplomatike aktuale në Tiranë tregon se ka një staf prej 12 diplomatësh, përfshirë një ambasador!). Misioni kinez ka ende seksionet ekonomike, kulturore dhe politike dhe një Atashe Ushtarak.
5. Në frontin ushtarak, Z. Hessling raportoi se kishte parë shumë ushtarë meshkuj dhe femra në rrugët e Tiranës dhe komentoi se kjo pa dyshim ndodhte për shkak të fushatës së shqiptarëve kundër papunësisë. Ai tha se të gjithë njerëzit në Shqipëri kryenin shërbimin ushtarak dhe se sipas diplomatëve në Tiranë numri i stërvitjeve ushtarake është rritur gjatë muajve të fundit, veçanërisht pas shpërthimit të trazirave në Kosovë. Si shënim në fund të faqes i kësaj situate, z. Hesseling tha se ndërkohë që ecte me makinë nëpër fshatra në



Shqipëri, kishte vënë re se ishin hapur mijëra "llogore" në shpatet kodrinore dhe në tokat anash rrugëve; disa prej tyre ishin ndërtuar natyrisht me madhësi për një person dhe disa të tjera për më shumë se një person. Ai tha se të gjitha kishin mbulesë konvekse prej betoni mbi to me një prerje horizontale për të siguruar një fushë zjarri.
6. Do ju dërgoj një letër të shkurtër mbi raportimin e kësaj situate dhe një kopje të listës së diplomatëve në Tiranë për FCO.

I Juaji,
J. Ward

**-62-**
ENO 015/3
29 qershor 1981

**Vizita e gazetarëve të huaj në Kosovë**

1. Michael Battey i "Reuters", më ka treguar gjatë një dreke të premten më 26 qershor mbi vizitën e tij të fundit në Kosovë së bashku me gazetarë të tjerë të huaj.
2. Battey tha se vizita e tyre ishte organizuar mirë dhe se gazetarët kishin qenë të lirë për të lëvizur nëpër Prishtinë pas përfundimit të programit të ditës së parë. Përshtypja e tij ishte se masat e sigurisë ishin ende të dukshme dhe ruanin një profil shumë të lartë. Forcat e policisë patrullonin qytetin me helmeta çeliku në kokë dhe kallashnikovë mbi supet e tyre. Forcat e Ushtrisë Popullore Jugosllave shiheshin jashtë Ministrisë dhe ndërtesave të tjera të rëndësishme. Ndërkohë që ecte nëpër Prishtinë, ai vuri re se kinematë ishin ende të mbyllura dhe se e vetmja zbavitje e hapur ishte pista e lojës me gjyle; megjithatë, rruga kryesore ishte e mbushur me njerëz në mbrëmje dhe gazetarët të cilët e njihnin Prishtinën dalluan diçka që nuk e kishin parë kurrë më parë. Ai vuri re policë jashtë orarit të punës që dukeshin të relaksuar, duke qeshur e bërë shaka, por, Battey vazhdonte, ata ishin një tufë gangsterësh me fytyra të rënda kur ishin në shërbim. Ai tha se kishte parë shumë aktivitet përreth Aeroportit të Prishtinës me avionë ushtarakë Mig-19 që praktikonin fluturime të ulëta mbi qytet dhe më pas zbritje dhe fluturime në aeroport. Ai kishte dëgjuar se gjatë revoltave në fillim të prillit, Forcat Ajrore ishin angazhuar për të bërë fluturime të shkurtra mbi demonstruesit me shpejtësi supersonike, me sa duket për t'i frikësuar ata më këtë uturimë sonike. Battey pa 3 tanke të vendosur në anë të lumit në rrugën për në Beograd. Ai tha se kishte policë të armatosur në të gjitha rrugët që të çonin në Prishtinë të cilët kryenin kontrolle në vend të automjeteve që hynin. Gjatë vizitës gazetarët shkuan tek Patriarkana në Pejë e cila ruhej nga roje të armatosura. Murgeshat aty thanë se kishin kërkuar mbrojtje pasi bandat e të rinjve që endeshin kishin krijuar shqetësime jashtë Patriarkanës, por që këto ngjarje nuk kishin qenë serioze.
3. Gjatë kohës që ishin në Prishtinë, gazetarët ndoqën një konferencë për shtyp që po jepte një anëtar i Kryesisë së Kosovës, i cili midis të tjerash, foli për diferencimin, dhe tha se ky proces do të ishte i ngadaltë, metodik dhe i plotë, por kur Battey e pyeti "kush vendosi aktualisht sekush ishte përgjegjës?, A ishte ky një rast ku personat përgjegjës gjykonin personat përgjegjës?" Personi nga Kryesia të cilit iu drejtua pyetja u vu në siklet, ishte tejet bishtnues dhe në fund nuk iu përgjigj pyetjes. Battey e pyeti gjithashtu "si është e mundur që informacioni për eksodin e serbëve dhe malazezëve nga Kosova sapo është bërë i njohur kur dihet gjerësisht se një gjë e tillë ndodh prej vitesh?". Përgjigja e tij ishte përsëri shumë e paqartë dhe Battey e përsëriti pyetjen e tij dhe më pas e pyeti se pse udhëheqja e Kosovës nuk kishte dijeni që kjo dukuri po ndodhte. Battey më tha se ai asnjëherë nuk mori përgjigje të kënaqshme për pyetjen e tij.
4. Battey kishte përshtypjen se të gjithë udhëheqësit shqiptarë në Kosovë, me të cilët ai kishte folur, ishin në pozita shumë mbrojtëse për sa i përket përgjigjeve të tyre dhe ngjarjeve të marsit dhe prillit; kjo e kishte bërë atë të arrinte në përfundimin se ata ishin shumë nacionalistë. Gjithashtu, sipas mendimit të tij, duke pasur parasysh mungesën e njerëzve të posteve të larta në radhët e atyre që ishin spastruar, ai kishte përshtypjen se kjo i jepte besueshmëri historisë që mundësia e ngjarjeve të tilla në Kosovë dihej që më parë, dhe në njëfarë mase këto ngjarje kishin ndodhur me bashkëpunimin e heshtur, në mos mbështetjen aktuale të këtyre udhëheqësve. Ai gjithashtu mësoi se kishte një dallim të qartë midis mënyrës se si Kosova i shikonte gjërat dhe mënyrës se si Jugosllavia i shikonte ato. Në këtë pikë, përshtypja e tij ishte se Kosova kishte ndër mend t'i bënte gjërat sipas mënyrës së vet dhe se ai mendonte që kishte një shkallë të qartë konsolidimi në radhët e udhëheqjes.
5. Gjatë informimit të përgjithshëm në Prishtinë, gazetarëve u ishte thënë se situata në Krahinë ishte tashmë shumë e qetë dhe se masat ende në forcë të sigurisë mund të hiqeshin shumë shpejt.
J Ward

**-63-**
**Konfidenciale**

Ambasada britanike
Beograd
1 korrik 1981
Përmbledhje
Kosova

1. Një vlerësim i mëtejshëm i Krahinës së trazuar (paragrafi 1).
Ngjarjet
2. Situata e sigurisë mbetet e pasigurt. Të huajt nuk lejohen të vizitojnë këtë zonë, përveçse nën mbikëqyrje të rreptë. Vazhdojnë rrëmujat në shkallë të vogël, ku përshihet reaksioni antishqiptar në Serbi. Programi politik për aksion zbatohet në rezistencë aktive dhe pasive dhe zhvillohet ngadalë. Marrëdhëniet me Shqipërinë janë përkeqësuar më tepër pas një shpërthimi me bombë në Ambasadën jugosllave në Tiranë; polemikat publike kanë vijuar; lidhjet kulturore janë ndërprerë (paragrafët 2-5).
Implikimet
3. Aftësia e vazhdueshme e nacionalistëve për të vepruar tregon një shkallë të gjerë simpatie, në mos mbështetjeje. Edhe nivelet më të larta të Partisë Krahinore nuk kanë dhënë asnjë shpjegim bindës për gabimet e tyre ndoshta sepse dashur pa dashur ata kishin inkurajuar idenë e statusit të Republikës. Popullsia joshqiptare lokale dhe autoritetet në Beograd ishin në dijeni të kësaj, por iu shmangën ballafaqimit. Tani vetë shqiptarët kishin provokuar një situatë të tillë, e mbase këtu mund të trajtohen disa aspekte tabu të Kushtetutës, por pa ndryshuar statusin e Kosovës (paragrafët 6-7).
4. Media e rriti lirinë e vet për raportimet në lidhje me Kosovën. Ka njëfarë kriticizmi formal për sensacionalizëm. Shtypi është i vendosur për të ruajtur dhe zgjeruar të drejtën e vet për të raportuar (paragrafi 8).
5. Kosova ka mbërthyer disa nga forcat e sigurisë së Jugosllavisë që kanë ndikuar në aftësinë e përgjithshme mbrojtëse të saj dhe ka ngritur pikëpyetje për besueshmërinë e njësive territoriale lokale shqiptare (paragrafi 9).
6. Një vështrim i ri po i jepet planit 5-vjeçar të zhvillimit të Kosovës. Por shkalla e lartë e lindjeve dhe ekzistenca e një sistemi të pabalancuar të arsimit bën të pamundur ndonjë përmirësim dramatik të ekonomisë së saj (paragrafët 10-11).
7. Jugosllavët janë të shqetësuar se Shërbimi i Fshehtë Inteligjent Rus dhe ai Bullgar nuk janë duke lënë pas dore Kosovën si objektiv i mundshëm. Disa jugosllavë thonë se Shqipëria duhet të inkurajohet që të dalë nga izolimi i saj para se elementët prosovjetikë të shfaqen në epokën pas Hoxhës, por e shikojnë si të padobishëm për momentin çdo gjest të tepruar ndaj Shqipërisë.
Përmbledhje
8. Kosova ka pasur efekte pozitive dhe negative. Në aspektin afatshkurtër, do të rikthehet stabiliteti megjithëse mund të priten trazira sporadike. Qetësia që ekziston pas vdekjes së Titos në Jugosllavi është tronditur rëndë dhe në aspektin afatgjatë do të jetë më e pasigurt.

**-64-**
**Konfidenciale**

Rt. Hon Lord Carrington KCMG MC
Ambasada britanike
Beograd
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
Londër S W 11 korrik 1981

**Kosova**

Shkëlqesia Juaj,
1. Në letrën time të datës 24 prill, kam dhënë një përshkrim të trazirave në Kosovë në mars dhe fillim të prillit 1981. Që atëherë, është ndërmarrë një program politik për aksion për të spastruar nacionalistët lokalë shqiptarë dhe për të rivendosur rendin në një krahinë ende të trazuar nga rrëmujat në shkallë të vogël. Ndërkohë, marrëdhëniet me Shqipërinë janë përkeqësuar më tej dhe Jugosllavia shfaqi shqetësimin e saj për përfshirje të mundshme të sovjetikëve. Në këtë letër, kam bërë një pasqyrë të rendit të ngjarjeve dhe kam analizuar implikimet e tyre për të ardhmen e Jugosllavisë.
Ngjarjet
Gjendja e sigurisë
2. Më shumë se tre muaj pas demonstratave të para të zhvilluara nga studentët e Universitetit të Prishtinës, gjendja e sigurisë mbetet aq e pasigurt saqë të huajt nuk lejohen ende të hyjnë në këtë Krahinë, përveçse me marrëveshje të veçantë dhe nën mbikëqyrje të rreptë. Hyrja e diplomatëve është plotësisht e ndaluar; gazetarët mund të vizitojnë vendin vetëm në grupe të kontrolluara me kujdes; dhe madje turqit të cilët e kanë origjinën në Kosovë, por që aktualisht banojnë në Turqi nuk lejohen që të vijnë në këtë krahinë për të vizituar të afërmit e tyre. Zyrtarët jugosllavë këmbëngulin që kufizimet bëhen për arsye sigurie, gjë që në pamje të parë është një pranim i trishtuar për një vend që krenohet për sigurinë e tij. Realiteti është ndoshta disi më ndryshe: autoritetet qendrore duan qartazi të minimizojnë rrezikun e përfshirjes së huaj me nacionalistët.
3. Në këtë mënyrë, është e vështirë të përftohen informacione drejtpërdrejt të besueshme mbi situatën në Kosovë prandaj duhet të bazohemi kryesisht në burime publike. Këto burime, nxjerrin në pah në mënyrë gjithnjë e më të detajuar shkallën e shtrirjes dhe thellësinë e shqetësimit. Pas dhunës që pasoi në fillim të prillit, pati një përgjumje deri në fund të muajit, kur raportet flisnin për akte të ndryshme të provokimit nacionalist, duke përfshirë përpjekjet për të organizuar demonstrata të reja gjatë festimeve të 1 majit. Pas disa ndërprerjeve të zhurmshme, Universiteti i Prishtinës dukej sikur do të shpërthente përsëri, prandaj nga mesi i muajit maj, studentët u dërguan në shtëpi 10 ditë para përfundimit të semestrit. Kjo lëvizje mund të ketë ndikuar vetëm në përhapjen e problemit, pasi nga shumë qytete përreth dhe më tej në zonat e banuara nga shqiptarët në periferi të Kosovës, me gjithë sigurimin e rreptë, raportet flisnin për incidente që përfshinin shkrimin e parullave, pamflete në qarkullim, kërcënime dhe dhunën e ushtruar ndaj shqiptarëve. Në disa pjesë të Serbisë, pati raporte mbi dëmet që i janë shkaktuar pronave të shqiptarëve dhe shfaqjen e parullave antishqiptare. Zërat për përleshje të

armatosura nuk ishin të vërtetuara, por milicia speciale dhe njësite ushtarake janë instaluar në këtë zonë, ndoshta për shkak se forcat lokale nuk ofrojnë shumë mbështetje dhe gjithashtu për shkak se autoritetet qendrore nuk po lënë asgjë në dorë të fatit.

Situata politike

4. Situata politike gjithashtu po normalizohet shumë ngadalë. Po has në vështirësi Programi i aksionit i shpallur nga Kryesia e Kosovës, sipas të cilit Partia dhe organizata të tjera duhej të spastronin të gjithë ata që kishin marrë pjesë në demonstrata apo kishin mbështetur nacionalistët në çfarëdo mënyre. Shtypi raportonte shembuj të shumtë të rezistencës aktive dhe pasive, që varionin nga refuzimi i plotë deri në bindjen ndaj direktivave të Partisë, nëpërmjet shmangies së hapur të përgjegjësisë nga zyrtarët bashkiakë dhe partiakë, në dorëheqjet e vonuara dhe shumë ngurruese të një grupi figurash drejtuese në udhëheqje dhe Universitet. Megjithatë, mbi 400 anëtarë më pak të rëndësishëm të Partisë janë përjashtuar dhe shumë të tjerë janë paralajmëruar, shumë mësues dhe nxënës janë përjashtuar nga shkollat, qindra studentë kanë humbur bursat e tyre dhe akomodimin, dhe një numër më i vogël punëtorësh kanë humbur punën e tyre. Përveç gjyqeve të publikuara të tre nacionalistëve nga komuniteti shqiptar në Maqedoni, një drejtësi e shpejtë, por e heshtur duket se ka dhënë dënimin për 500 veta dhe procedurat janë gati kundër 150 të tjerëve. Dëmi fizik është vlerësuar të jetë rreth 150,000£, megjithëse humbjet e shkaktuara nga dëmet e personave të paregjistruar deri te pasuritë e pasiguruara si dhe humbjet në prodhim duhet të tregojnë kosto shumë më të lartë të dëmeve të tilla.

Marrëdhëniet me Shqipërinë

5. Një shpërthim misterioz "me bombë" në Ambasadën jugosllave në Tiranë, më 23 maj, shënoi përkeqësimin e marrëdhënieve, e po kështu akuzat e jugosllavëve ndaj ambasadorit shqiptar për përfshirjen e tij personale në aktivitete subversive në Kosovë, p.sh. në krijimin e "troikës" ilegale. Polemikat publike vazhduan pa reshtur, ku shqiptarët bënin justifikime historike mbi statusin e Republikës për Kosovën, dhe jugosllavët publikonin aspektet më të këqija të jetës në Shqipëri, veçanërisht ndikimin në minoritetin Maqedonas dhe Malazez në këtë vend. Jugosllavët vazhduan të akuzonin shqiptarët për ndërhyrje flagrante në çështjet e brendshme, dhe e hidhnin fjalën te influencat e jashtme për ngjarjet në Kosovë. Natyrisht, siç kanë dëshmuar jugosllavët, Tirana ka përdorur me efektivitet marrëdhëniet kulturore dhe arsimore për të nxitur nacionalizmin shqiptar në Kosovë. Por, Beogradi nuk ka paraqitur ende asnjë provë të saktë të aktivitetit subversit të drejtuar nga Tirana. Po kështu jugosllavët nuk kanë lejuar që situata të përkeqësohej deri në atë masë sa të prishte apo pezullonte marrëdhëniet me Shqipërinë. Në vend të kësaj, ata kanë marrë një numër masash praktike, p.sh., pezullimi i marrëveshjeve kulturore midis Kosovës dhe Shqipërisë dhe nxitja e transmetimit në radio nga Prishtina në përpjekje për të kundërshtuar influencën ideologjike të Tiranës në këtë Krahinë. Linja zyrtare e interpretuar në nivelin më të lartë federal ishte se Jugosllavia vazhdon të kërkojë marrëdhënie të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunim me Shqipërinë, por që këtej e tutje në terma të barazisë dhe reciprocitetit të rreptë. Të gjitha marrëveshjet me Shqipërinë do të bëhen në nivel federal, d.m.th. nivel ndërshtetëror, dhe jo nëpërmjet protokolleve të negociuara në nivel lokal.

Implikimet politike të brendshme

6. Trazirat e vazhdueshme dhe rezistenca ndaj procesit të "diferencimit", siç quhet spastrimi, i veshi në mënyrë elokuente me gënjeshtër pretendimet e udhëheqësve të Partisë se trazirat ishin vepër e një pakice, mbeturina të borgjezisë së vjetër, Kominternit dhe bashkëpunëtorëve fashistë, të cilët kishin shumë pak të përbashkëta me masat e gjera të popullit. Nacionalistët vazhdonin të vepronin me pandëshkueshmëri të dukshme në disa zona dhe për këtë arsye duhet të kenë pasur një masë të gjerë simpatie, në mos mbështetjeje. Kjo reflektohet keq në qëndrimin e Partisë në bazë dhe aftësinë dhe gatishmërinë e saj për t'iu përgjigjur direktivave nga lart të Partisë. Me rëndësi më të madhe është rezistenca në nivelet më të larta të Partisë, veçanërisht dështimi nga ana e udhëheqjes së Kosovës për të dhënë ndonjë shpjegim bindës për gabimet e bëra, të cilat ia ka atribuar mungesës së vëmendjes, vigjilencës dhe informimit, deri te oportunizmi i individëve, e kështu me radhë. Asnjë nga ato pak shqiptarë drejtues të cilët, nën presion të madh dhe me ngurrim të dukshëm deri tani kanë dhënë dorëheqjen, nuk e ka pranuar fajin e tij publikisht.

7. Shpjegimi i vërtetë është pothuaj i sigurt se ata dhe shqiptarë të tjerë në udhëheqjen e Kosovës, dashur pa dashur, kanë inkurajuar rritjen e nacionalizmit shqiptar duke pretenduar në mënyrë të qëndrueshme për Kosovën të gjitha atributet e pavarësisë nga Serbia. Ideja e statusit të Republikës për Kosovën kishte fituar në këtë mënyrë përhapje të gjerë dhe një shkallë miratimi zyrtar; megjithëse udhëheqja nuk përparoi me kërkesat për bashkim me Shqipërinë, ka të ngjarë që ata i pëlqenin synimet e atyre të cilët kërkonin që Kosova të bëhej Republikë. Pjesa joshqiptare e udhëheqjes, të cilët nuk kishin si të mos e dinin se çfarë po ndodhte - pasi, siç e ka zbuluar edhe shtypi, lidhjet formale me Serbinë po injoroheshin haptazi në të gjitha mënyrat - ose kishin frikë të flisnin hapur ose, ajo që ka më shumë të ngjarë, u është thënë nga autoritetet në Beograd që të mbanin gojën mbyllur. Këto autoritete ishin paralajmëruar nga Kardelj në vitin 1977 se situata ekonomike dhe politike në Kosovë ishte e keqe dhe se një kundërrevolucion po gatuhej, por ata zgjodhën që të mbanin fshehur vlerësimin e tij, me sa duket për të shmangur provokimin e një përballjeje me shqiptarët e Kosovës duke ndërhyrë në çështjet e tyre të brendshme.

8. Meqenëse vetë kosovarët kanë provokuar përballjen, ka mundësi që të trajtohen një numër çështjesh të hapura në marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë. Marrëdhënia kushtetuese është e mbushur me paqartësi dhe anomali, që rezultojnë nga shpresa fillestare se tre pjesët përbërëse të Serbisë do të bashkëveprojnë së bashku në frymën e vullnetit të mirë, gjë që siç rezultoi, ishte më e dallueshme për mungesën e një fryme të tillë. Siç më tha kryetari i Gjykatës Kushtetuese: rruga për në ferr është shtruar me qëllime të mira! Ai vazhdoi më tej duke e bërë absolutisht të qartë se nuk mund të kishte asnjë ndryshim në statusin e Kosovës, meqenëse shqiptarët e Kosovës përbënin vetëm një minoritet etnik të një populli që jeton në një vend fqinj dhe



për rrjedhojë nuk barazohej me "kombet" e tjera në mazhorancë të Jugosllavisë të cilat kishin të drejtën kushtetuese të shtetit si republika brenda federatës. Do të ishte absurde, ai tha, që minoriteteve t'i jepej statusi i shtetit, dhe të tilla pakica, shtetet e të cilave ndodhen jashtë Jugosllavisë, ka shumë në Jugosllavi. Për më tepër, një gjë e tillë do t'i hapte rrugën shkëputjes së tyre dhe bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, duke minuar në këtë mënyrë integritetin territorial të Jugosllavisë.

9. Me interes të gjerë është efekti i jashtëzakonshëm që ka pasur Kosova për lirinë e informimit. Edhe televizioni, i cili fillimisht ka mbetur mjaft prapa shtypit në pasqyrimin e Kosovës, i është përgjigjur me entuziazëm licencës për të hetuar gabimet e kryera aty. Kohët e fundit, udhëheqja serbe është ndjerë e detyruar të kërkojë një qasje më shumë konstruktive dhe më pak selektive nga media, sepse ishte haptazi e alarmuar nga mënyra se si media, veçanërisht shtypi i ilustruar i Beogradit, sensibilizonin në veçanti gjendjen e serbëve në Kosovë, duke nxitur në këtë mënyrë gjithnjë më shumë shpërngulje dhe duke provokuar një reagim të ashpër të serbëve. Gazeta politike e përjavshme "NIN" hodhi poshtë me vendosmëri këto paralajmërime dhe mbështeti vazhdimin e qasjes së vet kritike "pa ekzagjerim, lustrim dhe fshehje". Megjithëse pasqyrimi i detajuar i ngjarjeve dhe komentet kritike kufizohen në masë të madhe me temën e miratuar të Kosovës, nuk ka të ngjarë që kjo situatë të përfundojë këtu. Në të vërtetë, shtypi është duke iu referuar shembullit të Kosovës për të justifikuar kërkesat e publikut që të marrë informacione në kohë, të plota dhe të sakta për tema të tjera.

Siguria

9. Ekzistojnë dy aspekte të implikimeve të ngjarjeve të Kosovës për sigurinë jugosllave. Së pari, është e arsyeshme të supozohet se Kosova përbën një shterim për burimet mbrojtëse të Jugosllavisë dhe duhet të ketë të paktën një farë efekti të dëmshëm në aftësinë e përgjithshme të mbrojtjes, megjithëse kjo mund të jetë e përkohshme. Ekzistojnë gjithashtu efekte në doktrinën ushtarake mbizotëruese të Mbrojtjes së të Gjithë Popujve. Tani lind pyetja, se deri në çfarë mase populli i Kosovës mund të mbështetet në njësitet e veta territoriale lokale dhe organizatat e tjera para-ushtarake për të mbrojtur Krahinën e tyre, dhe Federatën, kundër një armiku të jashtëm? Shumë shqiptarë lokalë qartazi nuk i shikojnë "vëllezërit" e tyre nga Shqipëria si armiq. Në mënyrë të pashmangshme, informacionet për sigurinë është vështirë të merren.

Aspekti ekonomik dhe social

10. Menjëherë pas demonstratave të prillit, Qeveria e Kosovës ndërmori hapin befasues, duke marrë parasysh situatën, që është miratimi i planit të saj pesë-vjeçar. Pak më vonë u mor vesh se ajo e kishte tërhequr planin për rishqyrtim, me sa duket pas paraqitjes nga ana e republikave donatore të mënyrës se si janë shpërndarë ndihmat për zhvillim në industritë me kapital intensiv dhe punimet madhështore publike në vend të përqendrimit në bujqësi dhe industritë prodhuese të punës intensive. Pasojat e këtij ndryshimi janë të rëndësishme për të trajtuar problemin e rëndë të papunësisë në Krahinë, burimin e të paktën një pjese të ankesave të disa prej demonstruesve.

11. Kosova nuk mund të presë ndonjë përmirësim dramatik në ekonominë e saj për sa kohë që vuan nën barrën e përqindjes së lartë të lindjeve dhe një sistemi arsimor të drejtuar keq. Kërkesa për më shumë punë për gratë do të ndihmonte për të ulur përqindjen e lindjeve. Qëllimi i shpallur kohët e fundit për t'i drejtuar studentët drejt studimeve që do t'i kualifikonin për nevojat ekonomike të Krahinës, është një hap në drejtimin e duhur. Kjo lëvizje jep shpresë se mund të formojë një pjesë të një reforme më të gjerë arsimore sepse disproporcioni midis numrit të studentëve që studiojnë lëndë "joproduktive" dhe ato "produktive" është shumë i madh në të gjitha institucionet e arsimit të lartë të Jugosllavisë. Për më tepër, i gjithë sistemi është i mbingarkuar me një numër shumë të madh studentësh, shumë prej të cilëve nuk janë diplomuar në Prishtinë, që përbëjnë një masë prej 50%.

Aspekti ndërkombëtar

12. Deri më sot, konflikti midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë për çështjen e Kosovës nuk ka përfshirë asnjë palë të tretë. Megjithëse shqiptarët e kanë interpretuar heshtjen virtuale të rusëve për këtë çështje si provë të bashkëpunimit të këtyre të fundit në atë që e përshkruajnë si një komplot i Serbisë së Madhe/Rusisë kundër Shqipërisë, jugosllavët nuk kanë arritur në këtë joshje të veçantë. Por, disa jugosllavë të mirënjohur, përfshirë Ministrin e Jashtëm, kanë pranuar privatisht shqetësimin se Shërbimet e Fshehta ruse dhe bullgare nuk po neglizhojnë që të gjuajnë në ujëra të turbullta dhe madje mund të kenë ndonjë kontakt indirekt me Shërbimet e Fshehta shqiptare përmes organizatave të shumëllojshme shqiptare të emigrantëve jashtë vendit, të cilat kanë qenë aktive në demonstrimin e mbështetjes së tyre për opozitën në Kosovë. Me gjithë humbjen e vëmendjes në Poloni dhe Afganistan, thuhet se rusët nuk mund të anashkalojnë objektivin e mundësisë së paraqitur nga Kosova për të minuar stabilitetin e Jugosllavisë. Disa zyrtarë jugosllavë kanë argumentuar se kjo situatë e bën akoma më shumë urgjente nevojën që Jugosllavia dhe vendet e tjera të interesuara për integritetin e Jugosllavisë duhet të përpiqen të nxjerrin Shqipërinë nga izolimi para se të vijnë në krye elementët prosovjetikë pas epokës së Hoxhës. Por, zyrtarë të tjerë kanë shprehur shqetësimin për demonstrimet e tepërta të miqësisë për Shqipërinë në periudhën aktuale gjë që haptazi do të shikohej si e padobishme nga Jugosllavia.

Përmbledhje

13. Kështu, ngjarjet në Kosovë patën një efekt të përzier në zhvillimet e këtij vendi. Në aspektin pozitiv, këto ngjarje i dhanë udhëheqjes së përbashkët një impuls të ri për të qëndruar të bashkuar dhe për të mbrojtur integritetin e Jugosllavisë. Gjithashtu, këto ngjarje kanë bërë që autoritetet qendrore të rishikojnë zhvillimin social dhe ekonomik të Krahinës së bashku me kontributet që i janë bërë Kosovës nga Republikat e tjera. Shpërthimi i medies për të raportuar mbi Kosovën përbën një hap përpara në zhvillimin më të gjerë demokratik të vendit. Gjithashtu, ripohimi i kontrollit federal mbi marrëdhëniet me Shqipërinë duhet të sigurojë një bazë më të shëndoshë për politikën e fqinjësisë së mirë të Jugosllavisë. Megjithatë, në aspektin negativ këto ngjarje i kanë dhënë goditjen e parë të rëndë një prej trashëgimive më të mëdha të Titos, d.m.th. "vëllazërisë dhe unitetit" që përbëjnë gurin themelor të Federatës. Kështu, jo vetëm që në Kosovë u rizgjua forca përçarëse e nacionalizmit, por, si një reagim ndaj shprehjeve të dhunshme të ndjenjave shqiptare kombëtare, ka pasur një rigjallërim edhe të ndjenjave serbe. Ngjarjet kanë treguar gjithashtu se sa e përciptë është influenca e Partisë në Kosovë, ku populli duket se është më shumë i frikësuar sesa bashkëpunues dhe udhëheqja lokale është qartazi në mosmarrëveshje me Beogradin.

14. Çfarë do të ndodhë në të ardhmen? Udhëheqja qendrore vazhdon të ndjekë një kurs tejet të ekuilibruar: me durim por me vendosmëri duke ripohuar kontrollin e saj dhe ndërkohë duke vazhduar politikat e saj të zhvillimit. Mendoj, se thjesht me anë të përpjekjeve, ajo do të shtypë forcat përçarëse në Kosovë dhe do ta kthejë Krahinën në gjendjen e saj të qëndrueshme si më parë. Por, natyrisht që do të ketë më shumë shpërthime sporadike, mundet edhe terrorizëm, dhe, në një periudhë afatgjatë, mund të ketë më shumë trazira serioze nëse kërkesat e kosovarëve për statusin e republikës nuk përmbushen në njëfarë mënyre. Kjo, pasi fakt është se nacionalizmi shqiptar është i rrënjosur thellë dhe, si rezultat i përqindjes së tyre të lartë të lindjeve, të plotësuar nga emigrimi i vazhdueshëm i serbëve dhe malazezëve, shqiptarët mund të përbëjnë afërsisht njëzet vitet e ardhshme, jo më 78% të popullsisë që përbëjnë aktualisht, por pothuaj 100% të banorëve të Krahinës. Gjithashtu, ekziston edhe mundësia që të ndërhyjnë forcat e jashtme. Shqipëria padyshim që do të vazhdojë propagandën dhe subversionin, të cilat do të forcoheshin nëse një regjim më i moderuar pason atë të Enver Hoxhës: Jugosllavia do të ketë vështirësi që të neutralizojë këto aktivitete, por duhet të jetë në gjendje të kufizojë efektet e tyre përçarëse. Bashkimi Sovjetik mund të përpiqet që të shfrytëzojë këto pakënaqësi: megjithatë, nuk ekziston asnjë shenjë aktuale për këtë. Por, çfarëdo që të sjellë e ardhmja në këtë drejtim, ngjarjet në Kosovë kanë trazuar fuqishëm zhvillimin e qëndrueshëm dhe paqësor që pasoi vdekjen e Titos majin e kaluar.

15. Një kopje të këtij informacioni po ia dërgoj Përfaqësuesve të Madhërisë së Saj në Athinë, Bon, Bukuresht, Budapest, Paris, Romë, Sofje dhe Uashington, Përfaqësuesit të Përhershëm të Mbretërisë së Bashkuar në Këshillin e Atlantikut të Veriut dhe Konsullit të Përgjithshëm të Madhërisë së Saj, në Zagreb.

I Juaji besnikërisht,

E. Bolland




Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Olti Hyseni: Jam danez, nuk luaj për Kosovën

PRISHTINË, 28 MARS - 16-vjeçari Olti Hyseni shënoi golin e tij të parë në ndeshjen e tij të parë në shtëpi për Sønderjyske, duke thyer rekordin e Simon Poulsen si golashënuesi më i ri në historinë e klubit. Vendasi i Sønderborgut ëndërron të luajë jashtë vendit, por së pari dëshiron të jetë titullar në ekipin e Sønderjyskes. Gëzimi i madh kaploi tifozët kur Hyseni shënoi golin e fundit pak para përfundimit të ndeshjes në shtëpi ndaj Næstvedit. Me vetëm 16 vjet, 4 muaj dhe 7 ditë, Hyseni u bë golashënuesi më i ri i Sønderjyskes në historinë pothuajse 20-vjeçare të klubit.
"Ishte një ëndërr fëmijërie që u bë realitet. Ishte thjesht fantastike që të shënoj gol si vendas në debutimin tim", ka thënë Olti për "Nordschleswiger".
Më pas, në intervistën për "Nordschleswiger", Hyseni preku edhe temën e përfaqësimit të Kosovës, por tha që as nuk e konsideron këtë gjë pasi e ndien veten danez. "Nëna ime erdhi në Danimarkë në vitin 1999. Babai im nuk kishte nënshtetësi daneze dhe nuk u lejua të vijë. Në vitin 2007 ai mori lejen e qëndrimit dhe erdhi në Danimarkë, një ditë para se të lindja unë. E kam ndjenjën që ka pak Kosovë në mua. Më shumë jam danez. Kam lindur dhe jam rritur këtu, dhe të luaj për Kosovën nuk është në konsideratën time. Ndihem danez, dhe Danimarka ka gjithashtu kombëtaren më të mirë", ka deklaruar Hyseni.
Olti Hyseni ka katër ndeshje për grupmoshat U16 dhe tri për grupmoshat U17 për Danimarkën. Megjithatë, ai mund të kishte luajtur për Kosovën. 16-vjeçari është djalë i prindërve kosovarë, por ka lindur dhe është rritur në Sønderborg.



# Jashari kërkohet nga Bologna

Luzern, 28 mars - Futbollisti i Kombëtares së Zvicrës, Ardon Jashari, është një prej lojtarëve që mund të bëjë një aventurë të re gjatë merkatos së verës. Mediet italiane raportojnë se skuadra e Bolognas e ka futur në listën e lojtarëve të dëshiruar për sezonin e ardhshëm. Jashari mund të luajë sezonin e ardhshëm në Serinë A dhe trajneri Thiago Motta është një "tifoz" i lojtarit me origjinë shqiptare. 21-vjeçari ka zhvilluar 26 ndeshje me Luzernin në Superligën e Zvicrës, ku ka shënuar pesë gola dhe ka dhënë dy asistime. Bologna nuk është klubi i vetëm që kërkon shërbimet e tij, pasi ka skuadra edhe nga Zvicra e Liga 1 në Francë që kërkojnë ta kenë pjesë të ekipit të tyre.



## SHKURT

### 'Fluturon' vlera e Hysenit dhe Hazrollajt

Muhamet Hyseni dhe Drilon Hazrollaj kanë pësuar rritje të madhe të vlerës së tyre në treg. Sipas "Transfermarkt", tani ata vlejnë 600 mijë euro, aq sa Lumbardh Dellova, shuma e të cilit nuk ka ndryshuar. Hysenit iu ka rritur vlera për 250 mijë, kurse Hazrollajt për 200 mijë. Kujtojmë se kjo dyshe është duke shkëlqyer në këtë edicion të Superligës, njëri me Llapin e tjetri me Malishevën.

### Guardiola në ankth, shtatë lojtarë në dyshim për ndeshjen ndaj Arsenalit

Manchester City do të luajë në fundjavë një ndeshje tepër të rëndësishme, atë kundër Arsenalit. Trajneri Pep Guardiola është me dhimbje koke për faktin se një listë e konsiderueshme është bërë me lojtarë që janë në pikëpyetje për sfidën ndaj "Topçinjve". Plot shtatë lojtarë janë në mëdyshje për këtë betejë të ashpër trofeu të Premierë Ligës. Akanji, Walker, Stones, Ederson, De Bruyne, Grealisht dhe Nunes janë emrat e lojtarëve që vuajnë nga dëmtimet. Një pjesë e mirë e këtyre lojtarëve pësuan lëndime gjatë miqësoreve me kombëtaret e tyre përkatëse ditët e fundit.

### Bellingham: Dua trofe

Jude Bellingham po shkëlqen me fanellën e Real Madridit. Në sezonin e parë me "Los Blancos", mesfushori është shndërruar në një protagonist absolut, duke ndihmuar skuadrën për arritjen e rezultateve të rëndësishme. Në një intervistë të dhënë së fundi, Bellingham ka folur për objektivat. "Çfarë objektivash keni? Trofetë. Dua të jem në gjendje t'i jap vendit tim, Anglisë dhe ekipit tim, Real Madridit, kujtime të shkëlqyera dhe disa trofe", ka thënë Bellingham.

### Stambolli do të organizojë Lojërat Evropiane 2027

Edicioni i katërt i Lojërave Evropiane do të mbahet në Stamboll të Turqisë në vitin 2027. Kështu ka vendosur Komiteti Ekzekutiv i E0C-ut në mbledhjen e mbajtur javën e kaluar. Presidenti i EOC-ut, Spyros Capralos, është shprehur i lumtur që Lojërat Evropiane do të organizohen në Turqi. "Ky është një lajm shumë i mirë për sportistët e Evropës dhe qytetin. Turqia dhe Stambolli kanë qenë për një kohë të gjatë miq të sportit ndërkombëtar. Ne e dimë se do të jetë vendi i përsosur për sportistët më të mirë të Evropës që të shkëlqejnë në vitin 2027", ka thënë Capralos. Pas edicionit të tretë të mbajtur vitin e kaluar në Krakow të Polonisë, organizatorët e Stambollit dhe EOC duan ta zgjerojnë ngjarjen, duke ofruar më shumë gara kualifikuese për Lojërat Olimpike Los Angjelos 2028.

## Drejtori i Mercedesit: Hamiltonit nuk i shkon e kuqja

